

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit MP në Psikologji Klinike

Ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Arjana Muçaj

Dr. Silvana Loka



(Shkurt/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP në Psikologji Klinike

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Albanian University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr 89, dt 10.02.2010 Shkresë MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	UMASH Nr 327, datë 07.08.2012 VKA Nr 355, datë 13.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master professional në “Psikologji klinike”
6	Cikli i studimit:	Ckli I parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik*
8	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite*
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Numri i studentëve	20 studentë
	Etj	

Shënim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

*Deri në vitin akademik 2018-2019, programi është ofruar me 1.5 vite dhe me 70 kredite

Programi është riorganizuar në 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademik me Vendim Senati Nr. 6 datë 28.02.2018. Ky riorganizim është miratuar me shkresë MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018.



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit MP në Psikologji Klinike

Në vendimin Nr.89, datë 10.2.2010, u miratua hapja e programit Master i Nivelit të Dytë në Psikologji Klinike. Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007, Neni 26, i ndryshuar më datë 22.07.2010, Senati Akademik i Albanian University, në Vendimin Nr. 192, datë 25.01.2011, miraton riorganizimin e programit Master i Nivelit të Dytë në Psikologji Klinike në programin Master Profesional në Psikologji Klinike. Në këtë Vendim nuk është e përcaktuar sasia e ECTS të këtij program studimi pas riorganizimit.

Programi i studimit Master Profesional në Psikologjinë Klinike në Albanian University është akredituar për herë të parë me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 327, datë 07.08.2012, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit, Nr. 355, datë 13.07.2012. Në Vendimin e Këshillit të Akreditimit nuk janë të përfshira detaje lidhur me sasinë e ECTS apo të dhëna të tjera të përgjithshme të këtij program studimi.

Në kuadër të riorganizimit të programeve të studimit të kërkuara nga VKM nr.41, datë 24.01.2018 dhe Udhëzimit të MASR nr. 31, datë 29.12.2017, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, me një shkresë me nr. Extra prot, të datës 22.02.2018, i është drejtuar Dekanit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Në këtë shkresë Departamenti i përcjell programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike i riorganizuar me përmbajtje: 1) planin mësimor sipas programit të ofruar; 2) Rregulloren e programit dhe 3) Programet e studimit (syllabuset) për secilën lëndë.

Dekani i Fakultetit të Shkencave Shoqërore, me shkresën nr. 80 prot, datë 22.02.2018, i drejtohet Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave për të miratuar ndryshimet e propozuara. Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave miraton ndryshimet e bëra për riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike në shkresën nr. 80/1 prot, datë 26.02.2018. Në shkresën nr. 82 prot, datë 26.02.2018, Dekani i Fakultetit të Shkencave Shoqërore i përcjell ndryshimet e këtij program studimi për miratim pranë Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, i cili i miraton këto ndryshime në shkresën nr. 86/3, datë 27.02.2018. Me vendim nr.6 të Senatit, në mbledhjen e datës 28.02.2018, këto ndryshime miratohen dhe ngarkohen strukturat përkatëse për zbatimin menjëherë pas miratimit të këtyre ndryshimeve nga MASR.

Në shkresën nr.185, datë 08.06.2018, Rektorati i Albanian University i përcjell MASR të gjitha ndryshimet e bëra për riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Në kthim përgjigje, në shkresën nr. 6313/2, datë 18.07.2018, MASR shprehet dakord më Vendimin e Senatit Akademik dhe, në zbatim të Kreut III, pika 2/f të Udhëzimit Nr. 31, datë 29.1.2017, udhëzon Albanian University të marrë kontakt me QSHA për reregjistrimin e formave të reja të diplomave.

Aktualisht, programi studimit Master Profesional në Psikologji Klinike në Albanian University, në vitin akademik 2018-2019, ofrohet me 60 ECTS dhe në një vit akademik.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- 1 Prof As Arjana Muçaj
2. Dr Silvana Loka

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi është Specialistja e ASCAL, Suela Kromidha

Më datë 14.02.2019 nëpërmjet sistemit AMS por edhe zyrtarisht është dërguar në AU Draft RVJ. Më datë 18.02.2019 vijnë nga AU komente në lidhje me këtë Draft. Komentet i dërgohen GVJ me email. Ekspertet e vlerësimit, pasi u njohën me përgjigjen e Institucionit në lidhje me Draft RVJ, shqyrtuan pikë për pikë çdo koment në këtë përgjigje. GVJ ka konsideruar disa prej këtyre komenteve duke bërë ndryshimet përkatëse në rubrikat e Draft RVJ, ndërsa për pikat e tjera të cilat nuk kanë ndryshuar, GVJ ka dhënë edhe arsyen pse nuk bën ndryshim në Raport. Bashkëngjitur këtij Raporti, pas Anekseve është përgjigja e GVJ në lidhje me komentet e AU për Draft RVJ.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Në përfundim të procesit të parë të Akreditimit, në vendimin Nr. 355, datë 13.07.2012, Këshilli i Akreditimit ka dhënë rekomandimet e mëposhtme:

- a) Të përmirësohet ambienti i bibliotekës.
- b) Praktika mësimore për programin e studimit Master Profesional të jetë më e prekshme në terren.
- c) Të sigurohet që studentët e këtij program studimi dyhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin lidhur me përmirësimin e ambienteve të bibliotekës, institucioni ka bërë përpjekje për të përmirësuar situatën, duke përmirësuar kushtet fizike të bibliotekës si dhe me ofrimin e një librerie online (Questia.com). Sa i takon specifikisht programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, pas një vëzhgimi në mjediset e bibliotekës, biblioteka vazhdon të jetë e varfër, jo vetëm në tituj mbështetës për punë të avancuar të studentëve, por edhe në tituj të literaturës së detyrueshme apo të rekomanduara për lëndët e vetë programit. Ky rekomandim është plotësuar pjesërisht nga institucioni.
- b) Për rekomandimin lidhur me realizimin më efikas të praktikës, Drejtuesi i Departamentit deklaroi se institucioni ka bërë përpjekje për të drejtuar studentët në klinika të vetë pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, pasi ka patur vështirësi në realizimin e marrëveshjeve me institucione të tjera për shkak të numrit të lartë të studentëve dhe vështirësive të tjera burokratike për realizimin e këtyre marrëveshjeve. Vështirësia në krijimin e hapësirave më të shumta sa i takon praktikave të studentëve u konfirmuan edhe në takimin me stafin akademik të Departamentit. Institucioni nuk zotëron dokumentacion zyrtar, i cili të dëshmojë plotësimin e këtyre kritereve sipas detyrave të ngarkuara nga Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 327, datë 07.08.2012, në pikën 3, e cila përcakton që Albanian University do të duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Akreditimit, në vendimin Nr. 355, datë 13.07.2012, përpara fillimit të vitit akademik 2012-2013. Si konkluzion ky rekomandim vazhdon të mbetet i paplotësuar me gjithë përpjekjet e institucionit për mbarëvajtjen e praktikës profesionale në këtë program studimi.
- c) Për rekomandimin lidhur me detyrimin e studentëve për dhënien e provimit të gjuhës angleze në përfundim të studimeve në programin e studimit Master Profesional, në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015 (ndryshuar me Udhëzimin Nr. 11, datë 30.06.2016) "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", studentët e e ciklit të dytë "Master Profesional" përjashtohen nga ky detyrim.



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master Profesional në Psikologjinë Klinike ka si mision të ofrojë arsim dhe trajnim të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës profesional për aplikimin e teorive, dijeve, aftësive dhe kompetencave psikologjike në institucionet publike dhe private, të cilat e kanë themelore praninë e psikologut klinik. Objektivat e këtij programi studimi përshijnë formimin teorik të studentëve duke synuar më së shumti, aplikimin praktik të këtyre njohurive në praktikat përgjatë këtij programi. Kjo përgatitje, paralelisht me politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve, do të lehtësojë edhe futjen e studentëve të diplomuar në këtë program studimi në tregun e punës.

Përgjatë procesit të vlerësimit, mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, në takimet në institucion dhe dokumentacion mbështetës, sikurse u konfirmua si nga Drejtuesja e Departamentit edhe nga GVB, zhvillimi i këtij programi studimi nuk është paraprirë dhe as nuk është shoqëruar me një studim tregu, gjë e cila do të ndihmonte të kuptuarit e realizimit të objektivave të programit si dhe do të lehtësonte përpilimin e objektivave për të ardhmen. Në të dy ndryshimet që i janë bërë programit (për shkak të parashikimeve ligjore për riorganizim të programeve), nuk janë bërë ndryshime për të reflektuar domosdoshmërinë e ardhur nga analiza paraprake të ecurisë së programit. Në takimin me Drejtuesen e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës, u konstatua që në riorganizimin e fundit, në zbatim të kërkesave të VKM nr.41, datë 24.01.2018 dhe Udhëzimit të MASR nr. 31, datë 29.12.2017, grupi i ngritur pranë Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme për të bërë riorganizimin e këtij program studimi, ka propozuar vetëm uljen e ECTS për lëndë të caktuara, për ta bërë programin e studimit me 60 ECTS.

Gjithashtu, lidhur me lehtësimin e politikave për punësimin e të diplomuarve në këtë program studimi, u diskutua edhe kuadri i ri rregullues i profesionit të psikologut, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut”, më datë 26/05/2016. U konstatua se në këtë program studimi janë regjistruar studentë të diplomuar në profile të tjera (jo në psikologji), gjë e cila nuk do të mund t’i pajisë me licensë si psikologë në përfundim të studimeve në këtë program Master Profesional në Psikologji klinike. Studentët ishin kaotikë në deklaratat e tyre lidhur me informimin për Ligjin “Për Urdhrin e Psikologut”.

Shërbimet mbështetëse për studentët ofrojnë një mundësi shumë të mirë për të ndihmuar studentët të zhvillojnë edhe aftësi të tjera, të cilat do t’ua lehtësojnë përfshirjen e tyre në tregun e punës në të ardhmen, sikurse janë aktivitetet me natyrë humanitare apo sipërmarrëse. Në takimin me Zyrën e Koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentit u paraqit një dokumentacion i plotë i këtyre aktiviteteve të sipërpërmendura.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit (ashtu sikurse parashikohet edhe në Statutin e Albanian University). Ky program nuk është paraprirë dhe as është shoqëruar me një studim tregu, i cili do të mundësonte vlerësimin objektiv të nevojave të tregut të punës për psikologë klinikë. Informacioni lidhur me kërkesat e tregut të punës vjen nga studentë të diplomuar në Psikologji në Albanian University ose nga burime informale. Programi i studimit është hartuar në koherencë me vëmendjen e rritur për shërbime psikologjike në përgjithësi. Mungesa e një studimi tregu si dhe vështirësitë për të realizuar praktikat mësimore (sikurse u paraqit më sipër) e pengojnë vlerësimin e plotë të

	përputhjes së këtij profesioni me zhvillimin ekonomik të vendit më gjerë. Programi i studimit është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me vlerat kulturore të kombit, duke i ndihmuar studentët të njohin dhe aftësohen, përpos aftësive profesionale, edhe në dimensionet kulturore dhe etike të profesionit të psikologut klinik.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillimin e institucionit referuar raportit të paraqitur nga grupi i vlerësimit të brëndshëm si dhe nga biseda e kryer në institucion gjatë vizitës në të.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me Ligjin Nr 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe është reflektuar në Rregulloren e Programit të studimit Master Profesional në “Psikologji klinike”. Emërtimi i programit të studimit referuar RVB është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	“Strategjia për Zhvillimin Institucional të Albanian University 2017-2022” është dokumenti i cili, ndër të tjera, përfshin edhe orientimet lidhur me përmirësimin e programeve të studimit në vijim. Fakulteti i Shkencave Shoqërore si dhe vetë Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme kanë planet strategjike të zhvillimit, në të cilat përfshihen edhe treguesit dhe matësit e mundshëm të përmirësimit të mësimdhënies dhe të të nxënit në të ardhmen.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit (ashtu sikurse parashikohet edhe në Statutin e Albanian University).</p> <p>Programi i studimit është hartuar në koherencë me vëmendjen e rritur për shërbime psikologjike në përgjithësi. Mungesa e një studimi tregu si dhe vështirësitë për të realizuar praktikat mësimore (sikurse u paraqit më sipër) e pengojnë vlerësimin e plotë të përputhjes së këtij profesioni me zhvillimin ekonomik të vendit më gjerë. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillimin e institucionit referuar raportit të paraqitur nga grupi i vlerësimit të brëndshëm si dhe nga biseda e kryer në institucion gjatë vizitës në të. Programi i studimit është hartuar në përputhje me Ligjin Nr 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe është reflektuar në Rregulloren e Programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Fakulteti i Shkencave Shoqërore si dhe vetë Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme kanë planet strategjike të zhvillimit, në të cilat përfshihen edhe treguesit dhe matësit e mundshëm të përmirësimit të mësimdhënies dhe të të nxënit në të ardhmen.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Departamentit të

Psikologjisë së Përgjithshme

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, sikurse është përcaktuar edhe në dokumentat zyrtarë të Albanian University (duke përfshirë Statutin dhe Rregulloren e Fakultetit) është njësia e cila është përgjegjëse për mësimdhënien dhe

kërkimin shkencor në fusha të shkencave shoqërore. Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka si mision promovimin e zhvillimit të lirë të studimit, procesit mësimor të kërkimit shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë, kombëtare dhe ndërkombëtare, hapjen ndaj komunitetit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe bashkëpunimin me administratën shtetërore.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga katër departamente dhe drejtohet nga Dekani i Fakultetit. Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit. Ai drejton të gjithë punën mësimore e shkencore në fakultet. Ai harton planin e zhvillimit të fakultetit sipas njësive bazë, miraton planin kalendarik akademik të propozuar nga përgjegjësi i njësive bazë dhe përmbush të tjera të drejta dhe detyrime të përcaktuara në rregulloren e fakultetit. Fakulteti i Shkencave Shoqërore përfshin: organet drejtuese, njësitë bazë mësimore shkencore si dhe mbështetjet nga administrata. Zyra të tilla si: “Njësia e sigurimit të brendshëm të Sigurisë”, “Zyra e zhvillimit të kurrikulës”, “Zyra e kërkimit shkencor dhe botimeve akademike”, “Zyra e karrierës dhe Alumnit” si dhe “Zyra e koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentit”, janë zyra të ngritura në nivel universiteti, por ofrojnë shërbimet e tyre në mbështetje të Fakultetit të Shkencave Shoqërore gjithashtu.

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në Albanian University ka gjithsej të angazhuar një staf akademik prej 29 pedagogësh, nga të cilët 10 janë PAE dhe 19 janë PAK. Nga PAE, një është me gradën Prof. Asoc. Dr., pesë PAF janë me gradën Dr., dy janë me gradën Dr. proc dhe një është me gradën MSh. PAE si dhe PAK janë të formuar në Psikologji ose në profile mbështetëse të saj, sikurse janë Psikiatria apo Pedagogjia. Në programin e studimit Master Profesional në Psikologjinë Klinike janë të angazhuar katër personel akademik me kontratë dhe një personel akademik efektiv. Personeli akademik i deklaruar në RVB kuadrante me kontratat e vlerësuara në Zyrën e Burimeve Njerëzore, por në takimin me studentët, ata (studentët) deklaruan se iu jepnin/kishin dhënë mësim pedagogë të tjerë nga ata që ishin deklaruar në RVB, në takimin me Drejtuesen e Departamentit, në takimin me GVB si dhe në takimin me stafin akademik.

Departamenti, në çdo fillim viti akademik, bën vlerësimin nëse paraqitet nevoja për të angazhuar staf akademik nga departamente të tjera ose personel akademik nga institucione jashtë Albanian University. Për programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, për vitin akademik 2018-2019 nuk është angazhuar personel akademik nga departamente të tjera, por nga institucione jashtë Albanian University, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilin e programit.

PAE kanë si përgjegjësi kryesore tyren mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Ata gjithashtu janë përgjegjës edhe për punë administrative për Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme si dhe pjesëmarrës apo drejtues të grupeve të caktuara të punës që ngrihen në departament sipas nevojave të veçanta. Pedagogë të caktuar janë përgjegjës për kërkimin shkencor si dhe për praktikat studentore. Kjo strukturë e organizmit të punës u konfirmua në RVB, në dokumentacionin bashkëngjitur atij si dhe në të gjitha takimet e realizuara nga GVJ.

Stafi akademik, si efektiv edhe me kontratë, në masën më të madhe të tij, vazhdojnë të jenë të angazhuar në mësimdhënie pranë këtij departamenti prej një periudhe të gjatë, me pedagogë të angazhuar prej një periudhe thuhet 10-vjeçare. Në programe të caktuara, përfshirë programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, ka patur prurje të reja të stafit vit pas viti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga katër departamente:

- 1) Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
- 2) Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative
- 3) Departamenti i Shkencave Juridike
- 4) Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Në “Albanian University”, sipas strukturës akademike, Fakulteti drejtohet nga Dekani i Fakultetit si dhe ka dy Zv. Dekanë: Zv. Dekani për Proçesin mësimor; Zv. Dekani për Kërkimin Shkencor. Zv. Dekanët mbulojnë fushat

e përcaktuara sipas strukturës së universitetit. Zv. Dekani kryen detyrat sipas fushës që mbulon në institucion të cilat përcaktohen nga Dekani, dhe në mungesë me porosi të tij, nënshkruan aktet përkatëse.

Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion.

Përgjegjësi i njësisë bazë është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë e Departamentit, formimin e grupeve mësimore dhe funksionimin e tyre. Përgjegjësi i njësisë bazë ndjek rregullisht dhe sistematikisht zbatimin e programeve të studimeve nga pedagogët, vlerëson programet dhe drejton zhvillimin e tyre në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës. Përgjegjësi i njësisë bazë ndërton planin e plotë të veprimtarive ekstrakurrikulare dhe të iniciativave kërkimore-shkencore, ideon, harton dhe propozon strategjitë e ecurisë dhe zhvillimit të njësisë bazë.

□ Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

Stafi akademik i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme është i përbërë nga 10 PAE dhe 19 PAK (Shiko anekse, tabela 2). Tabela me emrat përkatës të përbërjes së departamentit jepet në Anekse, tabela 3.

Në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, për vitin akademik është angazhuar vetëm një PAE. Procedurat e rekrutimit të stafit akademik variojnë nga procese të hapura të aplikimit përmes njoftimeve në faqen zyrtare të internetit të Albanian University deri në afrimin përzgjedhës të PAK nga vetë administratorët e Albanian University bazuar mbi kualifikimet dhe kredencialet e shquara të specialistëve të veçantë. Në RVB, në takimin me Drejtuesen e departamentit, takimin me GVB si dhe takimin me vetë stafin u konfirmua kjo mënyrë e rekrutimit të stafit në bazë të nevojave të vetë departamentit si dhe vetë procedura e rekrutimit. Ndërkohë, një antar i stafit deklaroi se ishte rekrutuar përmes një procesi ofrimi nga vetë Administratori i Albanian University, për shkak të kredencialeve akademike dhe profesionale.

Procesi i rekrutimit ka pësuar stanjacion prej një periudhe të caktuar kohore, me argumentin se mungojnë ekspertët në fushën e psikologjisë klinike. Kjo mungesë e stafit akademik efektiv ka sjellë edhe mbulimin e ulët të ngarkesës mësimore.

Mbështetur në të dhënat e Dosjes së Vetëvlerësimit, në evidencat përkatëse që shoqërojnë këtë Dosje, Stafi akademik i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, ndër vite, paraqitet si më poshtë:

Viti akademik 2012-2013 – 8 PAE (Dr në process) dhe 30 PAK (1 prof. Dr; 1 prof. As; 6 Dr; 10 Dr në proces; 10 Msc; 2 Specializim

Viti akademik 2013-2014 – 12 PAE (1 Prof Dr; 1 Dr; 7 Dr në process; 2 Msc dhe 1 Specializim) dhe 19 PAK (1 Prof. As; 9 Dr; 6 Dr në process; 3 Msc)

Viti akademik 2014-2015 – 11 PAE (1 Prof. Dr; 1 Prof As; 3 Dr; 6 Dr në process) dhe 12 PAK (1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 4 Dr; 3 Dr process; 2 Msc)

Viti akademik 2015-2016 – 15 PAE (1 Prof. As; 3 Dr; 7 Dr në process; 4 Msc) dhe 16 PAK (1 Prof. Dr; 4 Prof. As; 6 Dr; 4 Dr në process; 1 Msc)

Viti akademik 2016-2017 – 11 PAE (5 Dr; 4 Dr në process; 2 Msc) dhe 20 PAK (1 Prof. Dr; 4 Prof. As; 10 Dr; 2 Dr në process; 3 Msc)

Viti akademik 2017-2018 – 12 PAE (1 Prof. As; 6 Dr; 3 Dr në process; 2 Msc) dhe 20 PAK (3 Prof. As; 11 Dr; 2 Dr në process; 4 Msc)

Viti akademik 2018-2019 – 10 PAE (1 Prof As; 5 Dr; 2 Dr në proces; 2 Msc) dhe 19 PAK (1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 13 Dr; 2 Dr në proces; 1 Msc)

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme mbështetet nga 7 persona në funksionin e personelit administrativ.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Organizimi institucional i Albanian University i përshtatet misionit të vetë universitetit ashtu sikurse edhe është paraqitur edhe në Statutin e universitetit, duke u fokusuar në krijimin, zhvillimin, përhapjen dhe konsolidimin e një baze të gjerë e të përshtatshme të dijeve në shërbim të vendit me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe ofrimit të shërbimeve të tjera për shoqërinë.</p> <p>Albanian University ka 3 Fakultete: 1) Fakulteti i Shkencave Mjekësore; 2) Fakulteti i Shkencave Shoqërore 3) Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p> <p>Çdo fakultet ka në përbërje 3 ose 4 njësi bazë, nga të cilat dy janë departamente.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga katër departamente: 1) Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme; 2) Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative; 3) Departamenti i Shkencave Juridike dhe 4) Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Çdonjëri prej departamenteve ka objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar.</p> <p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në Albanian University për vitin aktual akademik 2018-2019 ka gjithsej të angazhuar 10 PAE. Staf akademik efektiv është i përbërë nga: 1 (një) Prof. Asoc. Dr., 5 (pesë) Dr., 2 (dy) proces të studimeve doktorale dhe 1 (një) MSh.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë dhe kryesore i njohin dhe i respektojnë përgjegjësitë dhe rolin e tyre në realizimin e programeve të studimit. Këto përgjegjësi janë të mirëpërcaktuara dhe të bashkërenduara në Statutin e universitetit dhe Rregulloret e njëjësive përbërëse të tij.</p> <p>Në varësi të nevojave për staf akademik, departamenti i përcjell nevojat Dekanit të Fakultetit, i cili i trasmeton në Rektorat. Pasi përcaktohen kriteret, thirrjet për vendet vakante bëhen publike në faqen zyrtare të AU. Në raste specifike, administratorët kanë rekrutuar staf akademik bazuar mbi kredenciale të shquara në fusha të caktuara.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Organizimi institucional i Albanian University i përshtatet misionit të vetë universitetit ashtu sikurse edhe është paraqitur edhe në Statutin e universitetit, duke u fokusuar në krijimin, zhvillimin, përhapjen dhe konsolidimin e një baze të gjerë e të përshtatshme të dijeve në shërbim të vendit me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe ofrimit të shërbimeve të tjera për shoqërinë. Albanian University ka 3 Fakultete Çdo fakultet ka në përbërje 3 ose 4 njësi bazë, nga të cilat dy janë departamente. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në Albanian University në vitin akademik 2018-2019 ka gjithsej të angazhuar 10 PAE dhe 19 PAK. Njësitë bazë dhe kryesore i njohin dhe i respektojnë përgjegjësitë dhe rolin e tyre në realizimin e programeve të studimit. Këto përgjegjësi janë të mirëpërcaktuara dhe të bashkërenduara në Statutin e universitetit dhe Rregulloret e njëjësive përbërëse të tij.</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi është i specializuar në fushën përkatëse, atë të Psikologjisë Klinike. Në këtë program studimi, duke iu referuar RVB dhe takimeve me drejtuesen e departamentit, GVB dhe stafin akademik të departamentit, në vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 5 pedagogë, nga të cilët 4 (katër) janë PAK dhe 1 (një) PAE, duke e reduktuar mbulimin e ngarkesës së mësimdhënies në masën 20%. Personeli akademik me kontratë është i punësuar si personel efektiv në universitete të tjera në vend. Profili i tyre akademik është në fushën e psikologjisë dhe psikiatrisë. Ashtu sikurse deklarohet në RVB, nga takimi me Drejtuesen e Departamentit si dhe me vetë GVB, programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike nuk mbulohej në masën 70% të ngarkesës së tij nga PAE me argumentin se “mungojnë pedagogët me grada në fushën e Psikologjisë Klinike si dhe mungon interesi i atyre që janë diplomuar në këtë fushë për t’u punësuar pranë AU”. Drejtuesja e departamentit deklaroi se ky raport është përmirësuar në shpërndarjen e ngarkesës për semestrin e dytë.

Për rekrutimin e stafit akademik, në cdo fillim viti akademik, Departamenti i përcjell Dekanin të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante dhe, pas përcjelljes së mëtejshme të këtyre kërkesave në Rektorat, dhe pas përcaktimit nga ana e tij (Rektoratit) e kriterëve të pranimit dhe procedurave të rekrutimit), thirrja për staf akademik (efektiv ose me kontratë) bëhet publike në faqen zyrtare web. Marrëdhënia e punës së stafit akademik, si efektiv ashtu edhe me kontratë, rregullohet përmes kontratës së punës. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore, pas verifikimit të katër dosjeve (një pedagog efektiv i departamentit, një pedagog me kontratë i departamentit, një pedagog efektiv i programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike dhe një pedagog me kontratë) u konstatua se dosja përmbante: kontratë me afat të pacaktuar (e cila kishte Aneks-kontratën, në të cilën përcaktoheshin lëndët dhe ngarkesa për semestrin përkatës); fotokopje e ID; vendimi i titullit akademik; diplomat universitare dhe pasuniversitare; CV; Libreza e punës si dhe leja nga institucioni në të cilin personeli akademik (në rastin e personelit akademik me kontratë) punon si staf efektiv. (Dr. A. C. nuk e kishte lejen nga Fakulteti i Mjeksisë).

Kriteret kryesore të aplikuara lidhur me rekrutimin e stafit akademik, të cituara në RVB, të deklaruara nga anëtarë të stafit akademik dhe të konfirmuara nga verifikimi i dosjeve të pedagogëve në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ishin:

- Përfundimi i ciklit të dytë të studimeve në profilin përkatës sipas lëndës që mbulojnë me mesatare mbi 8 (tetë);
- Të kenë së paku gradën shkencore “Doktor” ose PhD;
- Eksperienca në mësimdhënie dhe eksperienca profesionale, e lidhur me lëndën që do të mbulojnë;
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme personale për vendin e punës si dhe
- Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat,

Stafi akademik I anagazhuar në vitin akademik 2018-2019 paraqitet si më poshtë:

Viti akademik 2018-2019 – **1 PAE** (Dr) dhe **4 PAK** (1 Prof. Dr; 3 Dr) (Shiko Anekse, tabela 5)

Mbështetur në Evidencën 2.1 të Dosjes së Vetvlerësimit, Stafi akademik ndër vite paraqitet:

Viti akademik 2017-2018 – **2 PAE** (1 Dr; 1 Dr në proces) dhe **5 PAK** (4 Dr; 1 Dr në proces)

Viti akademik 2016-2017 – **2 PAE** (1 Dr; 1 Dr në proces) dhe **6 PAK** (5 Dr; 1 Dr në proces)

Viti akademik 2015-2016 – **4 PAE** (1 Dr; 2 Dr në proces; 1 Msc) dhe **4 PAK** (3 Dr; 1 Dr në proces)

Viti akademik 2014-2015 – **3 PAE** (1 Dr; 2 Dr në proces) dhe **3 PAK** (1 Prof As; 1 Dr; 1 specializim)

Viti akademik 2013-2014 – **5 PAE** (1 Dr; 2 Dr në proces; 1 Msc; 1 specializim) dhe **2 PAK** (2 Dr në proces)

Viti akademik 2012-2013 – **1 PAE** (1 Dr në proces) dhe **7 PAK** (1 Dr; 2 Dr në proces; 3 Msc; 1 specializim)

Përgjatë viteve akademik 2012-2018 nuk ka mbulim të programit në masën 70%, sikurse parashikon kuadri ligjor përkatës. Ka tendencë për përmirësim në vitet akademik 2013-2014 dhe 2015-2016, por edhe në këto vite ngarkesa nuk arrin në nivelin e 70% të planit mësimor.

Përsa i përket stafit të angazhuar në vitin akademik 2018-2019, në takimin me studentët, nisur nga deklaratimet e tyre, këta studentë dëshmuar se lëndët nuk mbulohehin nga pedagogët e deklaruar nga burimet e sipërcituara, me përjashtim të lëndës “Konceptimi dhe analiza e rasteve klinike” që u deklarua se jepej nga Dr. E. Zh., ashtu sikurse referohej nga burimet e mësipërme.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Në RVB nuk ka të dhëna lidhur me një Këshill Shkencor të programit, por në RVB është përcaktuar se Dr. D. T (PAE) është Përgjegjës për kërkimin shkencor. Kjo e dhënë u konfirmua nga Drejtuesja e Departamentit. Përsa i takon të dhënave për Koordinatorin e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, nuk ka referenca në RVB. Në takimin me Drejtuesen e departamentit si dhe në takimin me GVB u deklarua se Koordinator e programit të studimit ishte Dr. E. I. (PAE), ndërsa koordinator e praktikave studentore ishte I. H. (PAE/ Dr.proc).

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Ashtu sikurse u paraqit edhe më sipër, raporti i PAE/PAK të angazhuar në vitin akademik 2018-2019 (Shiko Anekse Tabela 6) në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike është 1/3. Përpos mospërputhjes së këtij raporti të deklaruar nga burime të ndryshme (RVB, drejtuese e departamentit, takim me GVB, takim me stafin akademik, takim me Zyrën e Burimeve Njerëzore si dhe takim me studentët), drejtuesja e departamentit deklaroi se ky raport është rregulluar duke e rritur ngarkesën e mbuluar nga PAE gjatë semestrit të dytë, por kjo ngarkesë nuk është pjesë e këtij vlerësimi.

Të dhënat sipas seksit

Duke iu referuar të dhënave të marra nga të gjitha burimet e tjera (jo nga RVB në të cilin listoheshin 5 pedagogë), stafi akademik dhe ai administrativ i angazhuar për programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, të klasifikuar sipas seksit janë paraqitur në Anekse, Tabela 7

Të dhëna sipas moshës së personelit

Bazuar në të dhënat e marra nga RVB si dhe nga dokumentacioni i kërkuar gjatë vizitës në institucion, klasifikimi sipas moshës i personelit akademik të angazhuar për programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike është paraqitur në Anekse, Tabela 8 dhe 8/1

Ashtu sikurse paraqitet në tabela, moshë mesatare e stafit akademik (PAE & PAK) i përket fashës moshore 36-45 vjeç, kurse moshë mesatare e stafit administrativ i përket moshave 25-35 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në RVB Deklarohet se personeli akademik punësohet sipas një kontrate pune në zbatim të Kodit të Punës. Fillimisht personeli punësohet me një kontratë 3-mujore, në përfundimin me sukses të së cilës personeli akademik

nënshkruan një kontratë pa-afat, të cilës i shtohen Anek-kontrata. Në aneks-kontratë përcaktohen edhe detaje lidhur me lëndët semestrale ose vjetore si dhe ngarkesën përkatëse të tyre. Këto kontrata dhe dokumentacioni mbështetës për punësim pranë Albanian University u verifikuan në vizitën në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Ndërkohë, edhe pse mungojnë detaje lidhur me informimin e stafit akademik si efektiv edhe me kontratë lidhur me procedurat e njohjes me të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me punësimin pranë Albanian University, stafi akademik (gjatë takimit me ta) konfirmoi procedurat e njohjes me to (të drejtat dhe detyrimet).

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Në RVB paraqitet staf ndihmës administrative me Msc si dhe të dhënat me moshën e stafit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Sipas të dhënave dhe verifikimeve të bëra nga GVJ, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në përputhje me objektivat e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike.</p> <p>Ashtu sikurse përcaktohet edhe në Statutin e AU, Rregulloret e Departamentit dhe të vetë programit, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, angazhohet në përputhje me strategjinë e AU, me fokus nxitjen dhe mbështetjen e zhillimit të profesionistëve të aftë.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë takimit me Drejtuesen e departamentit dhe GVB u deklarua se në fillim të çdo viti akademik Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen rishikimin e sulabuseve, me qëllim përmirësimin e tyre dhe ia përcjell departamentit. Në kuadër të riorganizimit të programeve të studimit të kërkuara nga VKM nr.41, datë 24.01.2018 dhe Udhëzimit të MASR nr. 31, datë 29.12.2017, pranë Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme është ngritur grupi i punës i përbërë nga Dr. D. T, Dr. E I. dhe Dr. B. L. dhe ka bërë përshtatjen e planit mësimor të programit Master Profesional në Psikologji Klinike në një program me 60 ECTS.</p> <p>Sipas analizës dhe verifikimeve të bëra, procesi i rekrutimit të personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Këto pasqyrohen plotësisht në kontratën e punës.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Sipas të dhënave të analizuar nga të gjitha burimet e cituara më sipër në raport, rekrutimi i personelit të ri është transparent dhe në përputhje me Kodin e Punës dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi</p> <p>Sa i takon realizmit të ngarkesës në masën 70% nga PAE, sipas përcaktimeve ligjore, kjo nuk është realizuar për këtë periudhë të vitit akademik 2018-2019, në të cilën ky mbulim është në masën 20%. Procedurat dhe rezultatet e vlerësimit të pedagogëve janë transparente. Vlerësimi i stafit akademik realizohet nga: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtuesi i Departamentit dhe studentët e programit të studimit. Rezultatet nuk përdoren si referenca për promovim të mëtejshëm të stafit akademik, por pedagogët më të vlerësuar lehtësohen në botimet në revistën “Optime” si dhe në pjesëmarrjen pa pagesë në konferencat shkencore të organizuara nga AU. Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit Master Profesional ka gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Titullarët dhe pedagogët e lëndëve në programin mësimor Master profesional në Psikologji Klinike kanë gradën: Prof. Dr (1 PAK) dhe Dr. (1 PAE dhe 2 PAK).</p> <p>Rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekanët dhe përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i programit Master Profesional në Psikologji Klinike janë të punësuar me kohë të plotë në Albanian University.</p> <p>Praktikat profesionale të programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike koordinohen nga I. H. (Dr. Proc) si dhe lehtësohen nga Zyra e Alumnit dhe karrierës.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike nuk realizon orë laboratorike.</p> <p>Në të gjitha takimet e realizuara me zyrat e ndryshme në Albanian University konstatohet gadishmëria për të mbështetur stafin akademik në realizimin e objektivave të programit Master Profesional në Psikologji Klinike.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik efektiv ka të përcaktuar një ngarkesë me bazë semestrash akademik. Maksimumi i ngarkesës së gjetur është 263 orë në semestrin e parë për një staf akademik efektiv.</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik vlerësohet me orë mësimore. Orët mësimore janë të shpërndara në auditor (leksione, seminare), orë pune individuale dhe orë udhëheqje studentësh.</p>
--	--

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore mbajnë një dokumentacion të hollësishëm, si për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, ashtu edhe për personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore, i plotëson kontratat e personelit akademik me aneks-kontrata për ngarkesën e parashikuar për çdo semestër. Kjo zyrë mban gjithashtu një dokumentacion të plotë edhe të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ.</p> <p>Në muajt korrik-shtator, pasi janë verifikuar nevojat nga Drejtuesi i Departamentit, i cili ia ka përcjellë Dekanit dhe më tej rektoratit, Zyra e Burimeve njerëzore bën njoftimin përkatës për rekrutimin e personelit akademik të nevojshëm për programe specifike të studimit.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Sipas të dhënave dhe verifikimeve të bëra nga GVJ, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në përputhje me objektivat e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Gjatë takimit me Drejtuesen e departamentit dhe GVB u deklarua se në fillim të çdo viti akademik Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informohet për rishikimin e sylabuseve të realizuara nga Grupet e Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel Departamenti, me qëllim përmirësimin e tyre. Ky proces monitorohet nga Zyra e Zhvillimit të Kurikulave. Në kuadër të riorganizimit të programeve të studimit është bërë përshtatja e planit mësimor të programit Master Profesional në Psikologji Klinike në një program me 60 ECTS. Programi mësimor në Masterin Profesional Psikologji Klinike, deri në organizimin e tij ka qënë i ofruar me 70 kredite. Sipas disa burime të sipërcituara, ka deklarata që ky program të jetë ofruar në masën 90 ECTS. Sipas të dhënave të analizuara nga të gjitha burimet e cituara më sipër në raport, rekrutimi i personelit të ri është transparent dhe në përputhje me Kodin e Punës dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sa i takon realizmit të ngarkesës në masën 70% nga PAE, sipas përcaktimeve ligjore, kjo nuk është realizuar për këtë periudhë të vitit akademik 2018-2019, në të cilën është ky vlerësim dhe as në vitet e mëparshme akademike. Për këtë semestër të vitit akademik 2018-2019 në të cilin zhvillohet vlerësimin nga GVJ mbulimi i ngarkesës nga PAE është në masën 20%, pasi mbulohet vetëm një lëndë me 6 ECTS. Titullarët dhe pedagogët e lëndëve në programin mësimor Master profesional në Psikologji Klinike kanë gradën: Prof. Dr (1 PAK) dhe Dr. (1 PAE dhe 2 PAK). Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore mbajnë një dokumentacion të hollësishëm, si për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, ashtu edhe për personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Zyra e Burimeve Njerëzore, i plotëson kontratat e personelit akademik me aneks-kontrata për ngarkesën e parashikuar për çdo semestër. Kjo zyrë mban gjithashtu një dokumentacion të plotë edhe të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ.



4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Sipas referimeve në RVB, Albanian University ka katër kampuse universitare, të gjitha të vendosura në godina lehtësisht të aksesueshme në afërsi të qendrës së Tiranës, me një sipërfaqe totale 10718 m². Fakulteti i Shkencave Shoqërore, pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, është i vendosur në godinën qendrore në Bulevardin “Zogu I”, me një sipërfaqe 3996 m². Ndërtesa i është nënshtruar vazhdimisht ristrukurimit (ndryshimi më i fundit ishte bërë në mjediset e bibliotekës që u verifikua gjatë vizitës në mjediset e saj) për t’iu përshtatur nevojave të ndryshme të kërkuara nga programet që zhvillojnë mësimin në këto mjediset. Mjediset ku zhvillohet mësimi janë të pajisura me mjete që lehtësojnë procesin e mësimin si dhe ofrohet një mbulim i plotë me shërbim interneti në të katërt godinat.

Biblioteka është zhvendosur në vitet e fundit në një hapësirë më të madhe. Ajo iu ofron studentëve akses në librarinë online Questia.com pasi i pajis me username dhe passëord-in kësaj librarie. Kjo librari online numëron 83.000 libra akademikë dhe mbi 10 milionë artikuj shkencorë, të nevojshëm për të mbështetur punën kërkimore si të stafit akademik ashtu edhe të studentëve. Faqet akademike në internet iu këshillohen studentëve edhe nga vetë personeli akademik në varësi të lëndëve të caktuara.

Sipas të dhënave të raportuara në RVB në bibliotekë gjenden 172 tituj librash. Në RVB referohet 23 tituj i përkasin programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, por këto tituj GVJ nuk arriti t’i gjente. Në bibliotekë, mungojnë tituj të teksteve të literaturës së detyrueshme dhe literaturës së rekomanduar të lëndëve të programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike.

Albanian University administron gjithashtu edhe një librari, e cila ndodhet në godinën në “Rrugën e Durrësit”. Në këtë librari studentët mund të gjejnë shumë tituj të librave të nevojshëm gjatë studimeve të tyre.

Revista “Optime” është revista zyrtare akademike e Albanian University. Në këtë revistë botohen të gjitha punimet shkencore të stafit akademik, prezantimet e bëra në konferencat shkencore të zhvilluara në Albanian University si dhe punime kërkimore të bëra nga studentët.

Albanian University Press është ndërmarrja botuese e cila, si pjesë integrale e Albanian University ka shërbyer për të bërë botimin e shumë titujve akademikë. Një pjesë e mirë e titujve janë literaturë e përkthyer nga kolanat e librave mësimorë të universiteteve të zëshme në Amerikë dhe Europë. Gjithashtu, kjo shtëpi botuese mundëson edhe botimin e teksteve mësimore të hartuara nga vetë stafi akademik.

Salla e konferencave është një mjedis mbështetës për aktivitete të ndryshme. Salla e konferencave e ndodhur në godinën në Bulevardin “Zogu I” është e pajisur me një sistem të plotë audio dhe video, projektor, rrjet të plotë të përkthimit simultan, duke lehtësuar në këtë mënyrë organizimin e konferencave, seminareve, simpoziumeve, leksioneve të hapura, etj.

Sipas të dhënave të referuara në RVB studentët ndihmohen në aktivitetin e tyre të përditshëm nga Laboratori i Informatikës për zhvillimin e orëve mësimore me fokus IT, për realizimin e projekteve me natyrë kompiuterike dhe multimediale, etj.

Kanali televiziv UTV vlerësohet gjithashtu si një instrument i mirë për të promovuar studentët me arritje të mira duke iu dhënë mundësinë që të marrin pjesë në programe me formate të caktuara, të lidhura me profilet e tyre të studimit dhe interesat e tyre të zhvillimit profesional në të ardhmen.

Mjediset shlodhëse për studentët përfshijnë kafeterinë dhe fastfood-in në katin e parë të ndërtesës.

Në takimin me GVB, u nda shqetësimi për mungesën e një vendparkimi.

Të gjitha godinat e Albanian University janë të pajisura me një mbulim të plotë me sistem sigurie, në mjediset e brendshme dhe të jashtme të godinave.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Sikurse është paraqitur në RVB, dhe gjatë vëzhgimeve në godinën ku zhvillon mësim programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, mjediset në këtë godinë janë në Anekse, tabela 9.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Godina në të cilën zhvillon veprimtarinë e tij Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ndodhet në Bulevardin “Zogu I”, Në të njëjtën godinë zhvillohet si procesi mësimor, ashtu edhe puna administrative.</p> <p>Godina në të cilën është i vendosur Fakulteti i shkencave Shoqërore i Albanian University, është i pozicionuar në qendër të qytetit që nga koha e hapjes së tij, qysh prej viti 2006.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike e zhvillon procesin mësimor vetëm në godinën në Bulevardin “Zogu I”.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike nuk ka në përmbajtjen e tij praktika mësimore që kërkojnë laboratorë në brendësi të godinës ku zhvillohet procesi mësimor. Praktikat profesionale zhvillohen në institucione të tjera.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit,</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Tekstet e parashikuara si literaturë e detyrueshme dhe literaturë e rekomanduar janë kryesisht në gjuhën shqipe si dhe janë tituj të cilët përdoren edhe nga universitete të tjera, ose kanë si autorë vetë staf akademik të AU.</p> <p>Në bibliotekë nuk kishte mjaftueshëm libra të cilët janë të parashikuar si literaturë e detyrueshme ose literaturë e rekomanduar.</p> <p>Biblioteka iu ofron studentëve akses pa limit në librarinë online Questia, e cila është një ndër libraritë më të njohura në lëmin e librarive shkencore në botë.</p> <p>Edhe pse pasurimi me tituj librash të cilët lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike ishte rekomandim i Këshillit të Akreditimit në vlerësimin e bërë në përfundim të procesit të parë të Akreditimit, në vendimin Nr. 355, datë 13.07.2012, Drejtuesi i Departamentit nuk deklaroi të kishte patur një plan konkret lidhur me pasurimin e bibliotekës me libra të përshtatshëm për këtë program studimi.</p> <p>Biblioteka e ofron shërbimin e saj gjatë orarit 08:-16:00 dhe i pajis studentët me kartelë regjistrimi. Ajo përshtat oraret e saj, në ndihmë të studentëve, edhe në sezone provimesh apo riprovimesh. Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike e ka zhvilluar dhe e zhvillon procesin mësimor ditëve të shtuna 08:00-16:30 dhe ditëve të diela 08:00- 15:00.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	



<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e paraqitura në RVB si dhe në vëzhgimet e bëra gjatë vizitës së GVJ në mjediset e Albanian University u konstatua se institucioni disponon mjediset e duhura për realizimin e programit mësimor, për më tepër që programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike zhvillohet gjatë fundjavës (ditëve të shtuna 08:00-16:30 dhe ditëve të diela 08:00- 15:00). Sallat e mësimimit janë të pajisuara me mjetet e duhura për procesin mësimor, duke ofruar PC, projektor, etj. Ky nuk është një program studimi që ka të parashikuar orë laboratorike pasi praktikat profesionale zhvillohen në institucione të tjera.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Godina në të cilën është i vendosur Fakulteti i shkencave Shoqërore i Albanian University, është i pozicionuar në qendër të qytetit që nga koha e hapjes së tij, qysh prej viti 2006. Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike nuk ka në përmbajtjen e tij praktika mësimore që kërkojnë laboratorë në brendësi të godinës ku zhvillohet procesi mësimor. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione të tjera. Biblioteka iu ofron studentëve akses pa limit në librarinë online Questia, e cila është një ndër libraritë më të njohura në lëmin e librarive shkencore në botë. Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike e ka zhvilluar dhe e zhvillon procesin mësimor ditëve të shtuna 08:00-16:30 dhe ditëve të diela 08:00- 15:00. Bazuar në të dhënat e paraqitura në RVB si dhe në vëzhgimet e bëra gjatë vizitës së GVJ në mjediset e Albanian University u konstatua se institucioni disponon mjediset e duhura për realizimin e programit mësimor, për më tepër që programi i studimit Master Profesional në Psikologjinë Klinike zhvillohet gjatë fundjavës (ditëve të shtuna 08:00-16:30 dhe ditëve të diela 08:00- 15:00). Sallat e mësimimit janë të pajisuara me mjetet e duhura për procesin mësimor, duke ofruar PC, projektor, etj.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Ashtu sikurse është paraqitur në RVB, burimi kryesor i të ardhurave për Albanian University janë të ardhurat nga tarifat e shkollimit si dhe aktivitetet të tjera tregtare të tilla si shërbimet mbështetëse argëtuese; kafe, mensa, bare, rezidenca, etj.

Një njësi e veçantë në AU është përgjegjëse për transaksionet financiare, menaxhimin e burimeve financiare dhe kontrollin periodik të tyre. Albanian University ka një raport financiar për çdo vit akademik i cili është i certifikuar nga ekspertë të huaj. Raporti për çdo vit pasqyron të dhëna të detajuara lidhur me të ardhurat e mbledhura nga tarifat e studentëve, fondin e pagave, pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative, etj.

Sa i takon kostove vjetore për çdo student, përllogaritjet bëhen në varësi të programit të studimit që studenti është duke ndjekur, për shkak të specifikave të çdo programi studimi. Programe të fushës së mjeksisë të tilla si: stomatologjia apo farmacia kanë një kosto më të lartë operative, ndaj edhe kostoja vjetore për studentët e këtyre programeve të studimit është më e lartë se e studentëve në programe të tjera.

Në një përllogaritje të mesatarizuar, rreth 1/3 e të ardhurave të grumbulluara nga tarifat e shkollimit të studentëve shkojnë për llogari të kostove administrative, të tilla si: qeraja e godinave, mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, sistemi i sigurisë, etj. Pjesa tjetër e të ardhurave shkon për fondin e pagave të stafit akademik dhe atij administrativ, mbulimin e shpenzimeve të reklamave, shërbimin e internetit, mirembajtjen dhe rinovimin e rrjetit kompiuterik, mjetet e konsumit të përditshëm të lidhura me higjenën, etj.

Sipas deklarimeve të shprehura në RVB, Albanian University ka zeruar tarifën e regjistrimit si dhe ka hequr tarifat shtesë për provime në sesionin e parë. Studentët paguajnë vetëm tarifën e shkollimit.

Të gjitha aktivitetet financiare të AU regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT) të lëshuar nga QKR.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje) paraqiten ne Anekse, tabela 10
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet përfshijnë: fondin e pagave për personalin akademik efektiv dhe me kontratë, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, mbulimin e plotë të veprimtarisë shkencore të organizuara nga AU, fondin e ekselencës si dhe shpenzimet operative të aktivitetit të përditshëm të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme. Kostoja e studentit të programit të studimit Master Profesional në Psikologjinë Klinike është përlllogaritur 500 euro për çdo vit akademik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Institucioni, në fund të çdo viti financiar i nënshtrohet një procesi auditimi nga një ekspert kontabël i miratuar. Gjithashtu institucioni, përmes Zyrës së Auditit të Brendshëm, që funksionon pranë Zyrës së Financës, në mënyrë periodike bën mbikëqyrjen dhe vlerësimin e pasqyrave financiare. Institucioni nuk ka përfituar asnjë grant të huaj apo të ardhura nga kontrata shërbimi Raporti i auditit synon të bëjë një analizë të plotë të mënyrës së përdorimit të të ardhurave që vijnë nga tarifat e studentëve për të siguruar rritjen e mëtejshme të cilësisë së studimeve edhe në programin e studimeve Master Profesional në Psikologji Klinike.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj. Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Në përfundim të çdo viti financiar, Albanian University harton një raport në të cilin janë të pasqyruara të gjitha kostot për realizimin e programit të studimit duke përfshirë: fondin e pagave dhe pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, pagesën për kostot administrative dhe operative, etj. Albanian University, bazuar në analizën financiare të bërë nga vlerësues të brendshëm dhe të jashtëm, vlerëson se ka qëndrueshmëri financiare gjatë periudhës në të cilën ofrohet programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike.
Konkluzionet e vlerësimit:	
Institucioni, në fund të çdo viti financiar i nënshtrohet një procesi auditimi nga një ekspert kontabël i miratuar. Gjithashtu institucioni, përmes Zyrës së Auditit të Brendshëm, që funksionon pranë Zyrës së Financës, në mënyrë periodike bën mbikëqyrjen dhe vlerësimin e pasqyrave financiare. Raporti i auditit synon të bëjë një analizë të plotë të mënyrës së përdorimit të të ardhurave që vijnë nga tarifat e studentëve për të siguruar rritjen e mëtejshme të cilësisë së studimeve edhe në programin e studimeve Master Profesional në Psikologji Klinike. Në përfundim të çdo viti financiar, Albanian University harton një raport në të cilin janë të pasqyruara të gjitha kostot për realizimin e programit të studimit duke përfshirë: fondin e pagave dhe pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetsore, pagesën për kostot administrative dhe operative, etj.	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sikurse përshkruhet në RVB, sistemi i Sigurimit të Cilësisë i ka zanafillat në vitin 2010. Me vendim të Senatit Akademik, nr. 178, datë 23.07.2010, ngriti Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe, së fundmi, në përputhje me ligjin 80/15, me Vendim nr. 4 të Senatit Akademik, datë 22.12.2016, ka miratuar ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Vlerësim Institucional. Kjo është një njësi e cila siguron përpilimin e politikave dhe procedurave të caktuara të cilat synojnë plotësimin e Standardeve Shtetërore të Cilësisë sikurse përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është në varësinë e drejtpërdrejtë të Rektorit të AU dhe përmes aksesit në çdo hallkë të universitetit, harton politika të cilat synojnë dhe garantojnë rritjen e cilësisë. Funksionet dhe detyrat e NjSBC janë të përcaktuara në nenin 14 të rregullores së Brendshme të Universitetit. Në një periodicitet të përvitshëm, kjo zyrë përpilon një raport vjetor në të cilin pasqyrohen vlerësime dhe analiza lidhur me cilësinë e mësimdhënies (për të gjithë personelin akademik efektiv dhe me kontratë), cilësinë e kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimeve administrative dhe operative, etj. Ky raport, i cili i paraqitet Senatit Akademik, pas miratimit publikohet në faqen zyrtare në web. Kjo transparencë i shërben vizionit të kësaj njësie për të garantuar rritjen e cilësisë dhe respektimin e vazhdueshëm të Standardeve Shtetërore të Cilësisë.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përpos rolit të saj monitorues dhe vlerësues, shërben gjithashtu si një pikë kyçe për të bërë koordinimin, këshillimin, bashkërendimin dhe mbështetjen e zyrave të tjera në Albanian University, të cilat, përpos specifikave të funksionit të tyre, punojnë edhe për sigurimin e cilësisë së shërbimeve në AU. Një ndër këto hallka është edhe Komisioni për Vlerësimin Institucional, në bashkëpunim me të cilin hartohen politikat e vetëvlerësimit, përcaktohen kriteret e vlerësimit të të gjithë aktorëve në universitet si dhe mundëson hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese.

Në takimin me drejtuesen e kësaj zyre. Znj D.A, GVJ u informua për procedurat standarde të punës së kësaj njësie dhe për risinë e aplikimit në këtë vit akademik të plotësimit të anketave vlerësuese nga studentët online. Anketat e vlerësimit nga studentët plotësohen në dy periudha kohore, gjatë procesit të mësimdhënies dhe në përfundim të procesit mësimor. NjSBC në Albanian University realizon focus-grupe që prej vitit 2016-2017, me nga 6-8 studentë përfaqësues për çdo program studimi të dhënat e grumbulluara nga këto focus-grupe përpunohen nga NjSBC dhe i përcillen Rektorit dhe më tej Senatit.

Në përfundim të fokus-grupit, studentët plotësuan edhe një pyetësor anonim. Të dhënat e grumbulluara nga vlerësimi i studentëve, iu bashkohen edhe pyetësorët e plotësuar nga stafi akademik lidhur me nivelin e kënaqësisë në punë, raportet semestrale të çdo departamenti si dhe rezultatet e studentëve në përfundim të vitit akademik dhe të gjitha këto të dhëna përpunohen në një raport vjetor.

Përpos kryerjes së vlerësimit të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbimeve administrative ndaj studentëve dhe stafit akademik me qëllim hartimin e rekomandimeve për rritjen e mëtejshme të cilësisë, NjSBC, me Vendim të Senatit Akademik, nr. 157/3, datë 08.09.2016, ka marrë edhe funksionin në nivel njësie bazë. Me atributet që i jep ky status, kjo njësi, në fillim të çdo viti akademik, gjatë vitit akademik dhe në përfundim të tij, bën rishikimin e sulabuseve, literaturës së propozuar si dhe formave të vlerësimit të studentëve. Kjo zyrë, në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme bëri edhe riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NjSBC për programin e studimit, si:
 - Çdo vit akademik organizohen dy fushata anketimesh me fokus cilësinë në mësimdhënie, në përfundim të çdo semestri;
 - Në anketimin e bërë në vitin akademik 2017-2018, në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike kanë marrë pjesë 35% e studentëve;
 - Pyetësorët janë përpunuar me metoda sasiore dhe cilësore dhe përfundimet i janë përcjellë edhe drejtueses së Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme;

- Ndër problematikat e nxjerra nga përpunimi i pyetësorëve mund të përmenden: problematikat në infrastrukturë, angazhimi i shumë pedagogëve për leksione dhe seminare duke krijuar konfuzion tek studentët, etj;
- Pedagogët e vlerësuar me mirë nga studentët mbështeten dukeiu krijuar lehtësira financiare për pjesëmarrjen në konferenca të organizuara nga AU ose në botimin në revistën shkencore “Optime”.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i Brendshëm i Cilësisë në Albanian University realizohet nga Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, i cili përbëhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni për Vlerësimin Institucional. NjSBC ka si funksion të saj drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e universitetit. Komisioni për Vlerësimin Institucional ka si fokus ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Brendshëm të Cilësisë në AU, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet për Sigurimin e Cilësisë.

Stafi i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë paraqitet në Aneksë, tabela 11

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Ashtu sikurse paraqitet edhe në RVB, dhe sikurse u deklarua edhe nga drejtuesja e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe nga vetë specialistja e NjSBC, kjo njësi bashkëpunon me departamentin përmes Grupeve të Sigurimit të Cilësisë. Grupi ad hoc i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme përbëhet nga tre pedagogë efektivë me gradën “Doktor” dhe me përvojë në mësimdhënie. Ky grup lehtëson punën e NjSBC në punën për rishikimin e sulabuseve, si pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit të departamentit përkatës, etj.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, si çdo departament tjetër në Albanian University, në përfundim të çdo semestri, realizon një raport semestral dhe një raport përmbledhës vjetor. Ky raport mbledh të dhëna të cilat shërbejnë si objekt analize lidhur me: procesin e mësimdhënies, ecurinë me literaturën, efikasitetin e përdorimit të lehtësirave logjistike, punën kërkimore-shkencore, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar rishtazi, kalueshmërinë dhe notën mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtarinë kërkimore-shkencore në nivel individual dhe departamenti. Të gjitha këto të dhëna i nënshtrohen analizës SWOT dhe përfundimet e këtij raporti, së bashku me sugjerimet për masat që duhen marrë për përmirësime në të ardhmen, i kalojnë Dekanin të Fakultetit;

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Në raportin vjetor që Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë i përcjell Rektoratit, parashtron edhe të gjitha sugjerimet lidhur me ndërhyrjet apo rregullimet që mund të bëhen për përmirësimin e standardeve të cilësisë për vitin pasardhës akademik. Këto sugjerime i kalojnë departamentit, ashtu sikurse u cilësua edhe në takimin me drejtuesen e departamentit, takimin me GVB dhe stafin akademik të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, dhe ashtu sikurse paraqitej në RVB. Departamenti i përdor këto sugjerime për të bërë ndërhyrjet e duhur apër të rishikuar sulabuset ose ndërhyrje të tjera.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Albanian University përdor një sërë metodash sasiore dhe cilësore për të matur dhe vlerësuar ecurinë e programit të studimit. Kjo bëhet në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri.

<p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Informacioni i marrë nga NjSBC, pas analizës, i kalohet Rektorit dhe nga aty merren vendime për ecurinë e mëtejshme lidhur me garantimin e parametrave të cilësisë.</p> <p>Në përfundim të paraqitjes dhe miratimit të këtij raporti të vlerësimit të brendshëm në Senat, rezultatet e tij, duke përfshirë edhe projektionet për të ardhmen, bëhen publike në faqen zyrtare në ëeb.</p> <p>NjSBC përdor këto metoda:</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Pyetësorë anonim të studentëve në përfundim të semestrave (2 herë në vit akademik); Fokus grupe në muajin dhjetor (me nga 6-8 studentë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga çdo program studimi); <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave mësimore, por vetëm në Tiranë pasi studentët nga rrethet e kryejnë praktikën në mjedisin e tyre të punës dhe nuk mbikqyren nga staf akademik.
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Raporti vjetor i NjSBC, pasi miratohet në Senatin Akademik publikohet në faqen zyrtare të AU. Raportet vjetore të NjSBC për 3 vitet e fundit publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit dhe mund të gjenden në linkun https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>NjSBC harton një analizë vjetore të bazuar në mbledhjen e të dhënave nga vlerësimet e studentëve dhe raportet semestrale të ardhura nga departamentet.</p> <p>NjSBC së bashku me Komisionin për Vlerësimin Institucional, pas analizës vjetore përpilojnë politika dhe proceduar të caktuara për të përmirësuar programe të studimit. Këto sugjerime iu shkojnë departamenteve përmes komisioneve ad hoc të sigurimit të cilësisë, të cilët aktivizojnë stafin akademik për të bërë përmirësimet përkatëse.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedurën të caktuar për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Albanian University është vlerësuar nga ekspertët e ASCAL, në bashkëpunim me ekspertët e QAA, dhe me vendim të Bordit të Akreditimit, nr. 90, datë 20.10.2017, ka marrë akreditimin institucional me kohëzgjatje 2-vjeçare.</p> <p>Albanian University ka ngritur strukturat përkatëse në nivel bazë për sigurimin e cilësisë dhe, në përputhje me Manualin “Procedurat dhe afatet e për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”, përdor instrumentat e përshtatshëm për të matur cilësinë dhe për të hartuar politikat e duhura për përmirësimin e mëtejshëm.</p> <p>Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit për Vlerësim Institucional bën një vlerësim periodik të cilësisë (çdo fund semestri dhe në fundvit) si dhe përdor procedurën të caktuar.</p> <p>Përmes Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti, NjSBC siguron shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të procesit të përmirësimit të programeve të studimit.</p> <p>NjSBC deklaron se bën trajnime të vazhdueshme për stafin e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e vlerësimit të cilësisë (anëtarët e komisioneve në nivel departamenti) si edhe për anëtarë të tjerë të stafit.</p> <p>Raporti vjetor i përcillet Rektorit së bashku me strategji të caktuara që propozohen si mënyrë për të përmirësuar cilësinë e institucionit. Ky plan=strategji, pas miratimit në Senat është publikuar në web.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Albanian University përdor një sërë metodash sasiore dhe cilësore për të matur dhe vlerësuar ecurinë e programit të studimit. Kjo bëhet në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri.</p> <p>Realizohen vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave mësimore, por vetëm në Tiranë pasi studentët nga rrethet e kryejnë praktikën në mjedisin e tyre të punës dhe nuk mbikëqyren nga staf akademik. Raporti vjetor i NjSBC, pasi miratohet në Senatin Akademik publikohet në faqen zyrtare të AU. Raporti vjetor i përcillet Rektorit së bashku me strategji të caktuara që propozohen si mënyrë për të përmirësuar cilësinë e institucionit.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Klinike është një program i cili synon të formojë psikologë klinikë, të cilët të mund të punësohen në klinika të shëndetit mendor, spitale, qendra të zhvillimit, etj. Studentët e regjistruar në këtë program studimi duhet të zotërojnë diplomën “Bachelor”.



Ky program studimi ka si objektiv të pajisë psikologun e ardhshëm klinik me njohuri në fushën e shëndetit mendor, psikopatologjive dhe psikodiagnostikimit përmes përdorimit të manualëve të ndryshëm statistikor dhe diagnostikë që përdoren sot në Europë dhe Amerikë. Përpos lëndëve me natyrë të mirëfilltë teorike, një pjesë e konsiderueshme e lëndëve, e lidhur kjo edhe me profilin praktik të këtij programi Master Profesional, e drejtojnë studentin drejt shprehive praktike të ushtrimit të profesionit të psikologut klinik, përmes praktikimit të elementëve të testimit dhe vlerësimit psikologjik, dhe teknikave për të konceptuar dhe vlerësuar raste të ndryshme klinike. Kuadri i formimit të studentit plotësohet nga njohja me elementë të rëndësishëm të formimit etik si psikolog.

Në kuadër të riorganizimit të programeve të studimit të kërkuara nga VKM nr.41, datë 24.01.2018 dhe Udhëzimit të MASR nr. 31, datë 29.12.2017, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, përmes procedurave të sqaruara në hyrje të këtij raporti, e riorganizoi programin e mëparshëm Master Profesional në Psikologji Klinike në Albanian University, si një program që ofrohej me 70 ECTS në 1.5 vite akademike, në një program studimi që në vitin akademik 2018-2019, ofrohet me 60 ECTS dhe në një vit akademik.

Si fillim duhet bërë një ndalesë sa i takon numrit të krediteve të këtij programi përpara riorganizimit të tij të sipërpermendur. Në RVB, përgjatë përshkrimit narrative të tij, i referohej programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, si një program që përpara riorganizimit të fundit (atij të përmendur më lart), ishte ofruar me 90 ECTS dhe në një periudhë 1.5 vite akademike. Të njëjtin informacion dha edhe njëri nga anëtarët e GVB. Edhe studentët këmbëngulnin që ata ishin regjistruar në një program që kishte 90 ECTS. Ndërkohë që, në tabelën bashkëngjitur RVB ku pasqyrohej plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike para riorganizimit, programi pasqyrohej me 70 ECTS. Të njëjtin qëndrim, për një program që ishte ofruar me 70 ECTS, mbajtën edhe Drejtuesja e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme si dhe perfaqësueset e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. Në përfundim të vizitës në institucion GVJ kërkoi dokumentin që paraqiste këtë program studimi përpara riorganizimit, dhe në këtë dokument programi paraqitet me 70 ECTS.

Programi i studimit Master Profesional në Psikologjinë Klinike është i ndarë në dy semestra, me 15 javë mësimore secili. Semestri i parë përfundon me 29 ECTS dhe semestri i dytë me 31 ECTS. Disiplinat mësimore dhe lëndët formuese në këtë program janë të organizuara në 5 kategori: Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) (totali 6 ECTS); Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B) (totali 24 ECTS); Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C) (totali 16 ECTS); Praktikë profesionale (D) (totali 6 ECTS) dhe Teza e Diplomës (E) (totali 8 ECTS).

Literatura e detyrueshme dhe literature e rekomanduar janë përzgjedhur në përputhje me misionin dhe objektivat e programit të studimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit në MP Psikologji klinike ka pranuar brezin e parë të studentëve në vitin akademik 2010-2011.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

➤ 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor

➤ 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë paraqitet në Aneksë

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

1 kredit (ECTS) është përlogaritur në këtë mënyrë:

▪ Për leksionet	12 orë në auditor dhe	13 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	7.5 orë në auditor dhe	17.5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Ushtrimet	15 orë në auditor dhe	10 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Detyrat/Projektet	2 orë në auditor dhe	23 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	20 orë në auditor dhe	5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	2 orë në auditor dhe	23 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Anekse, tabela nr 13)

Ndryshimet në kuadër të riorganizimit të programit e kanë prekur Planin mësimor në tërësinë e tij. Në të gjitha lëndët janë zbritur kreditë (ECTS) për të zbritur në nivelin e 60 ECTS në total. Megjithatë, ashtu sikurse edhe u pranua nga GVB, ky riorganizim nuk është shfrytëzuar nga Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim që të mund të bëheshin ndryshime më të thella për të reflektuar nevojat e ndryshme për ndryshim që mund të kenë dalë nga ofrimi i këtij programi prej një periudhe 6 vjeçare.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Shiko Anekse, tabela 14)

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MP në Psikologji klinike janë të fokusuar në kompetencat që studentët do të fitojnë përgjatë lëndëve si dhe përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi këndën. Emërtimi i lëndëve është bërë në përputhje me me kriteret e kërkuara që të jetë konkurrent në tregun si kombëtar dhe ndërkombëtar. Lëndët janë të ndara në semestra sipas rëndësisë së disiplinës së formimit. Lëndët që i përkasin disiplinës së përgjithshme i japin studentit një thellim teorik duke u kombinuar me aspektet praktike të lëndëve më specifike në programin e studimit. Forma dhe metoda e mësimdhënies duke ju referuar dhe takimeve me grupin e pedagogëve dhe grupin e studentëve u konstatua se përdorshin metoda bashkohore të mësimdhënies. Vlerësimi i studentëve kryhej nëpërmjet testeve dhe detyrave sipas planit mësimor në lëndët përkatëse. Në mbarim të çdo lënde studentit jepte provimin përfundimtar dhe vlerësohej me notë. Në çdo plan programi mësimor ka një harmoni midis literaturës bazë dhe asaj ndihmëse kjo për ti ardhur në ndihmë studentëve të këtij kursi.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm institucioni ofronte programe të akredituara të studimeve, të organizuara këto në module të vlerësuara në kredite ECTS. Programi i studimit sipas organizimit të ri bëhej nga 70 kredite në 60 kredite, që është dhe sasia e krediteve të grumbulluara nga studentët që ndiqnin këtë program studimi.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe gjëndjes së konstatuar në institucionin “Albanian University”, programi i studimit Master Profesional i pajiste studentët me njohuri të thelluara si teorike dhe praktike. Përsa i takonte trajnimit të mirëfilltë profesional institucioni duhej të punonte më shumë në këtë drejtim, ku studentët të aplikonin në terren njohuritë e marra nga pikëpamja praktike.</p> <p>Ky program studimi synonte të zgjeronte njohuritë e fituara në ciklin Bachelor për studentët që kishin mbaruar degën për Psikologji. Gjatë vizitës u konstatua se kishte dhe 2 studentë të cilat vinin nga një fushë tjetër studimi, gjë që e bënte më të vështirë plotësimin e njohurive të marra në nivelin Bachelor.</p> <p>Sipas takimeve të kryera në institucion dhe duke u bazuar në RVB e paraqitur nga institucioni programi i studimit Master Profesional i pajiste studentët me kompetenca të përgjithshme profesionale të cilat zgjeroheshin gjatë zhvillimit të programit të studimit.</p> <p>Referuar RVB dhe konstatimeve të bëra gjatë vizitës dhe takimeve në institucion Masteri Profesional ka objektiva të qartë profesionale, me synim arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB renditja e objektivave të programit të studimit, synon arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohej.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve në këtë program studimi, kryhej me anë të testeve të vazhdueshme për të matur njohuritë e marra dhe për të dëshmuar arritjet e studentëve në këtë program studimi.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikant e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Referuar RVB ky program studimi, mbështetej në përvojën disavjeçare të praktikave më të mira europiane.</p> <p>U konstatua gjatë vizitës si dhe duke ju referuar dhe RVB së institucionit, se ky program studimi është ndërkombëtarisht konkurrues për nga elementët që përmbanin të dhënat e përgjithshme si, objektivat kryesore, planin mësimor, kreditet, transferimin e krediteve sipas procedurave të transferimit të krediteve si dhe diploma që jepej në fund.</p> <p>Programi i studimit është i hartuar në përputhje me objektivat e përcaktura në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi studimit Master Profesional është një program i cili i përket studimeve të ciklit të dytë dhe përfshin aftësimin profesional.</p> <p>Referuar RVB ky program është i hartuar në përputhje me profilin e IAL dhe strategjinë e tij për zhvillim.</p> <p>Në takimin e kryer me personelin akademik në institucion si dhe referuar RVB, u konstatua se personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore.</p> <p>Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit përkon me arritjen e qëllimeve.</p>

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Duke ju referuar RVB, ky program studimi ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Gjatë vizitës në Departamentin e Psikologjisë u konstatua se programi i studimit Master Profesional synon plotësimin e nevojave në sektorët përkatës të ekonomisë vendase si dhe të huaj.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Programi i studimit merr parasysh nevojat e tregut të punës në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar referuar kjo dhe RVB së institucionit.
Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:	Vetë institucioni nuk është se ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës, por eksplorimi mbi nevojat e tregut të punës vjen si rezultat i kërkesës që kanë studentët për këtë program studimi por edhe nga programet që janë të hapura në universitete të tjera brënda vëndit. Institucioni bën një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; dhe një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program studimi gjë e cila u konstatua gjatë vizitës në institucion.
a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;	
b. kërkesat e punëdhënësve;	
c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;	
d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;	Referuar RVB institucioni ofron programe studime që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Programi i studimit synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Programi i studimit referuar RVB si dhe konstatimi i bërë gjatë vizitës në institucion realizohet me 60 kredite (ECTS).
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Referuar RVB informacioni për programin e studimit modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Ky informacion ofrohet në forma të ndryshme si të shkruara dhe elektronike.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Referuar RVB plani i diplomimit shpjegon qartë mënyrën e diplomimit në përfundim të programit të studimit.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
Ndryshimet në kuadër të riorganizmit të programit e kanë prekur Planin mësimor në tërësinë e tij. Në të gjitha lëndët janë zbritur kredite (ECTS) për të zbritur në nivelin e 60 ECTS në total. Megjithatë, ashtu sikurse edhe u pranua nga GVB, ky riorganizim nuk është shfrytëzuar nga Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim që të mund të bëheshin ndryshime më të thella për të reflektuar nevojat e ndryshme për ndryshim që mund të kenë dalë nga ofrimi i këtij programi. Bazuar në RVB dhe gjëndjes së konstatuar në institucionin “Albanian University”, programi i studimit Master Profesional i pajiste studentët me njohuri të thelluara si teorike dhe praktike. Përsa i takonte trajnimin të mirëfilltë profesional institucioni duhej të punonte më shumë në këtë drejtim, ku studentët të aplikonin në terren	

njohuritë e marra nga pikëpamja praktike. Referuar RVB informacioni për programin e studimit modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshëm për studentët. Ky informacion ofrohet në forma të ndryshme si të shkruara dhe elektronike. Referuar RVB plani i diplomimit shpjegon qartë mënyrën e diplomimit në përfundim të programit të studimit.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njesisë etj.

Procesi mësimor në Albanian University është në funksion të organizimit të vitit akademik, i cili fillon në datën e shpallur nga Ministri i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Viti akademik është i organizuar në dy semestra, me nga 15 javë mësimore secili. Në përfundim të çdo semestri është parashikuar një sezon provimesh, në të cilat studenti testohet për lëndët semestrale që ka ndjekur. Në muajin shtator është parashikuar një sezon riprovimesh.

Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike është i organizuar në dy semestra. Në semestrin e parë janë 4 lëndë të detyrueshme dhe një grup lëndësh me zgjedhje. Në përfundim të semestrit të parë studenti kalon një total prej 297 orë mësimore në auditor, 428 orë jashtë auditorit. Studenti kryen provimin në 5 lëndë dhe siguron 29 ECTS. Në semestrin e dytë studenti kryen 3 lëndë, praktikën profesionale si dhe temën e diplomës. Në përfundim të semestrit të dytë, studenti jep 3 provime, dorëzon Raportin e praktikës Profesionale si dhe testohet në “Temë diplome” dhe siguron 31 ECTS.

Mësimdhënia organizohet përmes leksioneve dhe seminareve, të cilat pedagogu i lëndës i realizon përmes shpjegimit klasik të njohurive në lëndët përkatëse, përmes materialeve në audio dhe video më të cilat studentët arrijnë të marrin pjesë në diskutime, përmes role-play dhe punëve në grup përes të cilave studentët arrijnë të praktikojnë, të mbikqyrur nga pedagogu i lëndës, njohuritë dhe aftësitë e lëndës përkatëse, etj.

Pavarësisht specifikave të secilës lëndë, në të gjitha lëndët studenti ndjek orë të përcaktuara leksione/seminare/detyra kursi ose projekte. Ai provohet me shkrim në një provim mes-semestral. Nota përfundimtare përmbledh pikët e grumbulluara në provimin përfundimtar në sezonin e përcaktuar, pikët nga provimi mes-semestral si dhe pikët e grumbulluara nga detyrat e kursit/projektet apo detyrime të tjera të përcaktuara nga pedagogu i lëndës si punë gjatë semestrit.

Pas riorganizimit të programit, organizimi i lëndëve sipas përcaktimeve të kategorive të tyre është: lëndë bazë (6 ECTS – 10%); lëndë karakterizuese (24 ECTS – 40%); lëndë ndërdisiplinore dhe lëndë me zgjedhje (16 ECTS – 27%); lëndë plotësuese dhe praktika profesionale (6 ECTS – 10%) si dhe detyrimet përmbyllëse (8 ECTS – 13%).

Bazuar në përlllogaritjet e bëra nga tabela e Planit Mësimor të programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike që GVJ iu vu në dispozicion nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, studentët kalojnë rreth 20 orë mësimore në auditor (saktësisht 19.8) dhe një total prej 1500 orë. Në RVB nuk ka referenca lidhur me realizimin e orëve në auditor, por në takimin me drejtuesen e departamentit si dhe në takimin me studentet GVJ iu konfirmuar se procesi i mësimit për këtë vit akademik zhvillohet në fundjavë, ditëve të shtuna dhe të diela me oraret: të shtunën 08:00-17:00 dhe të dielën 08:00-15:00. Sipas përlllogaritjeve, me këtë orar mësimor arrijnë të realizohen vetëm 16 orë mësimore, duke e bërë të paplotë realizimin e planit mësimor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Ashtu sikurse paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme, mësimdhënia realizohet përmes bashkërendimit të disa formave, duke përfshirë: leksione, seminare, ushtrime, praktikë dhe detyra kursi/projekte. Ky program mësimor nuk ka të parashikuar orë laboratorike dhe praktikë lëndore.

Programi i Studimit Master Profesional në Psikologji Klinike		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	240
b.	Seminare	120
c.	Ushtrime	106
d.	Laboratore	-
e.	Praktikë lëndore	-
f.	Praktikë profesionale	120
g.	Det/projekt	22
Në total		608

Format e kontrollit të njohurive

Në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, pavarësisht specifikave të lëndëve, format e kontrollit janë të standardizuara, duke përfshirë vlerësimin e studentit katër herë (në katër mënyra) gjatë gjithë semestrit: vlerësimin lidhur me nivelin dhe cilësinë e aktivizimit të tij/saj gjatë procesit mësimor dhe, kryesisht, gjatë orëve të seminareve në masën 10% të vlerësimit përfundimtar; vlerësimin e shlyerjes së detyrimeve të natyrës kërkimore, të njohura si “detyra kursi” në masën 10% të vlerësimit përfundimtar; vlerësimin në testime në periudha të ndryshme gjatë semestrit në masën 20% të vlerësimit përfundimtar si dhe vlerësimin në provimin përfundimtar në masën 60% të vlerësimit përfundimtar. Nga ky format vlerësimi bëjnë përjashtim: “Praktika profesionale” dhe “Tema e diplomës”.

Lidhur me lëndën “Praktikë profesionale” studenti vlerësohet nga pedagogu mbikqyrës i praktikës, bazuar mbi një raport praktike që studenti dorëzon në përfundim të praktikës së kryer pranë një institucioni. Në takimin me studentët, GVJ u njoh me faktin se studentët i kryejnë praktikat profesionale në vendet e tyre aktuale të punës, pa e patur shumë të qartë dallimin midis punës që bëjnë dhe praktikës profesionale si studentë të programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Studentët e kishin të paqartë rolin e pedagogut mbikqyrës të praktikës si dhe rolin e profesionistit nga i cili ata mbikëqyreshin në institucionin ku bënin praktikën.

Tema e diplomës mbrohet nga studenti përpara një komisioni të ngritur nga Drejtuesi i departamentit.

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10%
Testimet gjatë vitit	20%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Sipas të dhënave të paraqitura në RVB si dhe gjatë bisedës me drejtuesen e departamentit dhe Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve, studentët e psikologjisë angazhohen në aktivitete në nivel Fakulteti (14 studentë) si dhe në projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera (6 studentë). Zyra e Koordinimit dhe

Mbështetjes së Studentëve raportoi se ndër vite 2015 – 2018, studentë të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme kanë marrë pjesë në disa konferenca të organizuara në AU:

29 maj 2018 Konferenca Studentore e IV e Fakultetit të Shkencave Shoqërore me temë “Sistemi i drejtësisë në Shqipëri, Ndarja dhe kontrolli reciprok i pushteteve”, në të cilën ishin referues 4 studentë të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe 59 studentë pjesëmarrës.

31 maj 2017 Konferenca e III Studentore me temë “Konsolidimi i shtetit të së drejtës” në të cilën ishin referues 6 studentë të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe 60 studentë pjesëmarrës. 23 maj 2016 Konferenca II studentore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore me temë “Sfidat e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë në funksion të Integritimit në Bashkimin Europian” në të cilën ishin referues 5 studentë të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe 48 studentë pjesëmarrës.

8 prill 2016 Konferenca I Studentore me temë “Ligjshmëria, konceptimi dhe zbatimi në marrëdhëniet shoqërore” në të cilën ishin referues 3 studentë të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe 34 studentë pjesëmarrës.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Ashtu sikurse është paraqitur edhe më sipër në RVJ, pranimi i studentëve në programin e studimit Master Profesional në Psikologjinë Klinike ka ndjekur logjikën e: 1) plotësimit të kriktereve të përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë nr. 80/2015 si dhe kriteret në kuadër të Ligjit “Për urdhërin e psikologut”, nr. 40/16. Kriteret që studenti duhet të plotësojë për të ndjekur studimet në këtë program përfshijnë:

- 1) Zotërimin e një diplome të ciklit të parë të studimeve Bachelor apo të sistemit të vjetër të diplomave (minimum 3-vjet);
- 2) Plotësimin e kriktereve akademike të vendosura nga Komisioni i Pranimeve të njëjësive bazë;
- 3) Pagesën e tarifës vjetore të përcaktuar.

Në RVB përshkruhet që, në rastet kur studenti ka përfunduar një diplomë tjetër jashtë disilinës së caktuar më lart, atëherë një komisioni i veçantë i ngritur nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore bën vlerësimin e aplikimit bazuar mbi kriteret:

- 1) Dosja e aplikantit;
- 2) Motivimin e tij për të ndjekur programin e studimit të kërkuar.

Dosja e studentit, e verifikuar në dokumentacionin e Sekretarisë Mësimore, përmbante:

- Formular aplikimi;
- Mandat arkëtimi;
- Fotokopje ID;
- 2 Fotografi;
- Deklaratën e studentit;
- Fotokopjen e noterizuar të Dëftesës së Pjekurisë
- Fotokopjen e noterizuar të studimeve “Bachelor” në Psikologji;

Kritere specifike duke ju referuar RVB për pranimin e studentëve në këtë program studimi, nuk ka.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Studenti pritet nga personel i cili është kryesisht i angazhuar për procesin e regjistrimit të studentëve në periudhën kohore të përcaktuar nga MASR. Pas dorëzimit të dokumentave që dëshmojnë plotësimin e kriterëve për t'u regjistruar në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, studenti regjistrohet. Me hyrjen në fuqi të ligjit "Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë" nr. 40/16, në procesin e regjistrimit studentët duhet të informohen lidhur me përcaktimet ligjore për licensimin e tyre si psikologë në të ardhmen. Në mungesë të një diplome "Bachelor" në Psikologji, studentët duhet të informohen se diplomimi në Master Profesional në Psikologji Klinike mund t'iu sigurojë licensimin. Në RVB nuk ka të dhanë lidhur me këtë element të procesit të regjistrimit. Në takimin me GVB, studenti deklaroi se kishe përfunduar studimet Bachelor në një fushë tjetër (jo në Psikologji), e dinte se diploma në këtë program nuk do t'i siguronte licensën dhe se ai ishte informuar dhe se do të kryente edhe një program tjetër Master (gjë e cila nuk e bën të mundur licensimin).

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Sipas të dhënave të RVB (ashtu sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtëmë dhe sikurse u konfirmua nga verifikimi i rastësishëm i vlerësimit të studentëve përmes dokumentacionit gjatë takimit me Sekretarinë Mësimore) vlerësimi i studentëve përgjatë procesit të studimit në këtë program studimi ka reflektuar thujse të njëjtën notë mesatare në hyrje dhe dalje të studentëve. Nga kjo tendencë, bën përjashtim brezi i studentëve 2016-2017, mesatarja në dalje e të cilëve është ngritur me thujse 1.5 nota nga mesatarja hyrëse.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Ashtu sikurse është paraqitur në RBV, në anekse, tabela 14, janë paraqitur në formë të përmbledhur të dhënat sa i takon mesatareve hyrëse (të studentëve të regjistruar në vitin e parë, për herë të parë, si dhe të mesatareve dalje, të studentëve të diplomuar në vitin e fundit).

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Në RVB si dhe përgjatë gjithë vizitës së GVJ në Albanian University nuk pati asnjë referencë (të dhëna zyrtare) lidhur me mobilitetin e mundshëm të studentëve të programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Në takimin me Sekretarinë Mësimore si dhe në të dhënat e RVB ka referenca sipas të cilave: në vitin akademik 2016-2017 ka patur 1 student të regjistruar në vit të parë si program i dytë studimi dhe në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 19 studentë në vitin e dytë të programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike me transferim në vitin e dytë.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Në RVB, përveç të dhënave në shifra sa i takon punësimin të studentëve të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, mungojnë vlerësime dhe analiza më të detajuara lidhur me profilet e tyre të punësimin si dhe lidhjes së mundshme midis njohurive/aftësive të marra në këtë program studimi me kërkesat dhe ecurinë në vendin e punës. Në takimin me përfaqësueset e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit si dhe të Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentëve, të dhënat për punësimin e studentëve të diplomuar freskohen deri në 5 vjet pas diplomimit.

Numri total të diplomuarve

Ashtu sikurse është paraqitur në RVB, e konfirmuar nga Drejtuesja e Departamentit, GVB si dhe në dokumentacionin e verifikuar në Sekretarinë Mësimore, numri total i studentëve të diplomuar në vitet akademike 2012-2017 është 127 studentë në total. Në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 19 studentë për herë të parë si dhe një student që është në stazh nga viti pararendës.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Ashtu sikurse është paraqitur në RVB dhe e konfirmuar nga biseda dhe dokumentacioni i paraqitur nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit, numri total i studentëve të diplomuar të cilat janë punësuar në

përputhje me diplomën e tyre është 64. Numri i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën është 60. Për 3 studentë të diplomuar mungojnë të dhënat e punësimit të tyre. Shiko Anekse, tabela 16

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Studentët e regjistruar në programin e studimit Master Profesional në psikologjinë Klinike zotërojnë diplomën “Bachelor”. Disa prej tyre nuk e kanë diplomën në fushën e psikologjisë. Në të tilla raste, një Komision Ad Hoc vlerëson aplikimin e studentit duke marrë në konsideratë: dosjen e aplikantit dhe motivimin e tij për të ndjekur studimet.</p> <p>Studentët i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucioni për regjistrimin në këtë program studimi. Përmes Komisioneve të Pranimeve në nivel njësie bazë, Albanian University vendos kriteret akademike që aplikanti duhet të plotësojë për t’u pranuar si student në këtë program studimi. Kriteret akademike përkatëse nuk specifikohen, përjashtuar rasteve kur studentit aplikues ka përfunduar studimet bachelor në një fushë tjetër nga psikologjia.</p> <p>Lidhur me detyrimin e studentëve për dhënien e provimit të gjuhës angleze në përfundim të studimeve në programin e studimit Master Profesional, në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015 (ndryshuar me Udhëzimin Nr. 11, datë 30.06.2016) “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, studentët e e ciklit të dytë “Master Profesional” përjashtohen nga ky detyrim.</p> <p>Duke ju referuar RVB, institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit të studentëve në këtë program studimi dhe përpiqen të hartojnë plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në momentin e regjistrimit, gjatë javës së Orientimit si dhe përgjatë kontakteve gjatë viti akademik, Zyra e Karrierës dhe Alumnit si dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentit, i informojnë studentët për mundësitë për punësim.</p> <p>Në javë e parë të viti akademik, dy zyrat në mbështetje të studentëve, në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, i ofrojnë studentëve informacion lidhur me procese të lidhura me akreditimin apo njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës së lëshuar nga Albanian University, si brenda edhe jashtë vendit.</p> <p>Studentët iu ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nga dy zyra: Zyra e Karrierës dhe Alumnit si dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentit. Këto zyra mbështesin gjatë gjithë vitit studentët me aktivitete të lidhura me fushën e tyre të studimeve (dhe jo vetëm) si dhe iu vijnë në ndihmë studentëve me “Udhëzuesin për zhvillimin e karrierës” përmes të cilit studentët mund të</p>

	lehtësohen në formimin e tyre profesional, përtej njohurive dhe aftësive në fushën specifike të studimeve.
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Albanian University disponon statistika vjetore lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Këto të dhëna ruhen deri në 5 vjet pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna të plota, në regjistrin e rezultateve, lidhur me ecurinë e studentit që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tij, duke përfshirë: provime, ripovime, transferime, periudha stazhi dhe diplomim. Të dhënat janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, në Regjistrin e Rezultateve Akademike, në Regjistrin e Diplomave. Të gjitha këto të dhëna janë si në format të shkruar ashtu edhe elektronik. Të gjitha të dhënat statistikore iu përcillen, sipas ligjit dhe rregulloreve përkatës si MASR ashtu edhe Rektoratit të Albanian University.</p> <p>Albanian University disponon të dhëna të plota lidhur me ecurinë akademike të studentëve, të cilat reflektohen në Regjistrin e Rezultateve Akademike.</p>
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit disponon të dhëna të plota lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike dhe u përditëson këto të dhëna deri në 5 vjet pas diplomimit.</p> <p>Të dhënat e RVB si dhe të dhënat e tërhequra nga vizita në AU e GVJ nuk reflektojnë lidhur me mbajtjen e të dhënave sa i takon përparimit të mëtejshëm akademik të studentëve të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Punësimi i tyre Brenda ose jashtë profesionit është fokusi i zyrës së Karrierës dhe Alumnit.</p>
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Takimi me studentët reflektoi të dhëna kontradiktore sa i takon informimit të tyre lidhur me: sasinë e krediteve (ECTS) të programit si dhe mundësisë për licensim pas diplomimit në këtë program, në mungesë së diplomimit në Bachelor në Psikologji (sipas përcaktimeve të licensimit të psikologëve të përcaktuara në Ligjin “Për urdhërin e Psikologut” nr 40/16). Edhe studentët, ashtu sikurse shkruhej në RVB dhe sikurse u konfirmua nga një anëtar i GVB, deklaruan se programi Master Profesional në Psikologji Klinike ofrohej me 90 ECTS.</p> <p>Studentët informohen vazhdimisht sa i takon detajeve lidhur me vlerësimin e tyre. Informimi fillon në javën e parë orientuese, vijon me njoftimet e ndryshme që bëjnë sekretaritë mësimore përgjatë procesit mësimor lidhur me sezonet e provimeve/riprovimeve dhe periudhën e diplomimit. Staf i mbështetës i departamentit i mbështet</p>

	<p>vazhdimisht përmes përcjelljes së informacioneve dhe komunikimeve informuese.</p> <p>Prezantimi i vlerësimeve është transparent. Pedagogët i dorëzojnë vlerësimet në prani të studentëve, të cilët mund t'i tërheqin këto vlerësimeve edhe në një kohë më të vonë, në rast se nuk janë personalisht të pranishëm në ditën e publikimit të rezultateve. Sekretaria mësimore i informon studentët për rezultatet e tyre si për lëndë të caktuara, ashtu edhe për të gjitha lëndët ku studenti është vlerësuar në përfundim të semestrit ose vitit akademik.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së studentit mbështet studentët lidhur me ofrimin e njohurive bazë për karrierën e tyre (Manuali për Zhvillimin e Karrierës shërben si udhërrëfyes për aftësitë e nevojshme parapërgatitore për tregun e punës) si dhe në ofrimin e shumë aktiviteteve (konferenca, seminare dhe aktivitetet të natyrës së lidhur ngushtësisht me profilin e psikologjisë) përmes të cilave studentët të mund të njihen dhe të praktikojnë disa nga njohuritë që marrin përgjatë procesit mësimor.</p> <p>Procesi i praktikave është paksa i vështirë për shkak të mungesës së entuziazmit të vetë institucioneve pritëse për studentët praktikantë. Gjithësesi, Zyra e Karrierës dhe Alumnit si dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentit, në bashkëpunim me koordinatorin e programit lehtëson procesin e praktikës profesionale.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Studentët e regjistruar në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike zotërojnë diplomën “Bachelor”. Disa prej tyre nuk e kanë diplomën në fushën e psikologjisë. Studentët i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucioni për regjistrimin në këtë program studimi. Albanian University disponon statistika vjetore lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Këto të dhëna ruhen deri në 5 vjet pas përfundimit të studimeve. Zyra e Karrierës dhe Alumnit disponon të dhëna të plota lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në Psikologjinë Klinike dhe u përditëson këto të dhëna deri në 5 vjet pas diplomimit. Takimi me studentët reflektoi të dhëna kontradiktore sa i takon informimit të tyre lidhur me: sasinë e krediteve (ECTS) të programit si dhe mundësisë për licensim pas diplomimit në këtë program, në mungesë së diplomimit në Bachelor në Psikologji (sipas përcaktimeve të licensimit të psikologëve të përcaktuara në Ligjin “Për urdhërin e Psikologut” nr 40/16). Edhe studentët, ashtu sikurse shkruhej në RVB dhe sikurse u konfirmua nga një anëtar i GVB, deklaruan se programi Master Profesional në Psikologji Klinike ofrohej me 90 ECTS. Procesi i praktikave është paksa i vështirë për shkak të mungesës së entuziazmit të vetë institucioneve pritëse për studentët praktikantë. Gjithësesi, Zyra e Karrierës dhe Alumnit si dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentit, në bashkëpunim me koordinatorin e programit lehtëson procesin e praktikës profesionale.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njëjësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor në Albanian University koordinohet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Kërkimi shkencor është i organizuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/15 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.



Albanian University ka një organizim strukturor të kërkimit shkencor duke filluar nga aktivitetet kërkimore-shkencore në nivel të njëjesisë bazë, në aktivitete në nivel fakultetesh, në aktivitete në nivel Universiteti si dhe aktivitete në bashkëpunim me universitetet apo institucione të tjera kërkimore-shkencore si Brenda edhe jashtë vendit.

Kërkimi shkencor organizohet në trajtën e seminareve, simpoziumeve, tryezave të rrumbullakëta, konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe botimeve në revista shkencore. Për të lehtësuar procesin e publikimit të kërkimeve dhe të punës shkencore të stafit akademik si efektiv ashtu edhe të atij me kontratë, pranë Albanian University është ngritur dhe funksion shtëpia botuese “Ufo Press” si dhe revista periodike shkencore “Optime”. Në një pjesë të konsiderueshme të kërkimeve, pedagogë të AU kanë angazhuar studentë të degëve dhe programeve të ndryshme.

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka dhënë një kontribut të vazhdueshëm sa i takon aspektit të kërkimit shkencor në Albanian University, përmes organizimit të aktiviteteve të lidhura drejtpërdrejt me shkencën e Psikologjisë. Ashtu sikurse paraqitet edhe në RVB dhe sikurse u konfirmua në takimin me përfaqësuesen e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike dhe Drejtuesen e departamentit, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka kryer këto aktivitete, prej vitit 2012, kohë në të cilën është përfunduar procesi i akreditimit të parë të programit Master Profesional në Psikologji Klinike.

- (12-13 tetor 2013) Seminari me temë “Terapia geshtaltiste me fëmijët dhe adoleshentët”, me pjesëmarrjen e psikoterapistes Dr. Daniela Coco. Seminari u zhvillua në bashkëpunim me “Qendrën e trajnimit për psikoterapinë e integruar” dhe “Albanian Gestalt Institute”.
- (13-14 nëntor 2013) Seminari me temë “Cannabis dhe konteksti multidimensional i trajtimit të tij” në bashkëpunim me qendrën “Aksion Plus”.
- (dhjetor 2013) Seminari me temë “Meditimi Transcendental” në bashkëpunim me Organizatën Kombëtare të Meditimit Transcendental.
- (janar 2014) Simpoziumi me temë Psikopatologjitë e zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentët, ccështje të evidentimit, diagnostikimit dhe të ndërhyrjes afatgjatë” në bashkëpunim me “Save the children” dhe Departamentin e Punës Sociale të Universitetit të Tiranës.
- (Mars 2014) Simpoziumi me temë “Njohje me komunitetin LGBT” në bashkëpunim me Pink Embassy dhe CRCA.
- (prill 2014) Seminar për studentët e programeve Master me temë “Psikologu klinik dhe psikoterapisti: sfidat e një të ardhmeje të afërt” në bashkëpunim me Institutin Adler.
- (maj 2014) Seminari me temë “Akropoli i ri” në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative dhe Qendrën Filozofike-Kulturore.
- (qershor 2014) Konferenca Ndërkombëtare me temë “Tranzicioni dhe Shoqëria, një qasje multidisiplinare” në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Tetovës, Universitetin e Shkodrës dhe Institutin e Sociologjisë.
- (29 maj 2018) Konferenca studentore me temë “sistemi i drejtësisë në Shqipëri, ndarja dhe kontrolli reciprok i pushteteve” me referimin e punimeve shkencore të vetë studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Shiko Aneks tabelë 17)

Ashtu sikurse paraqitet edhe në tabelën përkatëse, kërkimet shkencore të zhvilluara në Albanian University në 5 vitet e fundit akademike janë të një game të gjerë. Nga aktivitetet e natyrës shkencore të listuara më sipër, numërohen 9 të tilla të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shkencën e psikologjisë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik publikon rregullisht artikuj dhe material shkencore si në përmbushje të detyrimeve për marrjen dhe avancimin në gradat shkencore ashtu edhe në drejtim të punës shkencore për rritje profesionale.</p> <p>Pjesa më e madhe e aktiviteteve shkencore në të cilat merr pjesë stafi akademik i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme në Albanian University janë të drejtuara nga përvoja e tyre profesionale si psikologë, faktor ky që i drejton aktivitetet në prodhimin e ideve, ndërhyrjeve ose vlerësimeve konkrete në lëmin e psikologjisë së zbatuar.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni nuk ofron programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor.</p> <p>Institucioni i ofron personelit akademik pjesëmarrjen në konferencat që organizon vetë AU si dhe botimin në revistën shkencore periodike "Optime". Vetë RVB thekson se AU duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme disponon një bazë të plotë të dhënash lidhur me studimet shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, si në kuadër të punës për avancimin në gradat shkencore, ashtu edhe për studime të tjera me interes personal.</p> <p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme disponon një bazë të plotë të dhënash lidhur me botime, artikujt shkencorë, pjesëmarrjet në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, kumtesat, tekstet mësimore, etj, për të gjithë personelin akademik të angazhuar me kohë të plotë ose kohë të pjesshme pranë këtij departamenti.</p> <p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme disponon një bazë të plotë të dhënash lidhur me projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Kërkimi shkencor në Albanian University koordinohet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Kërkimi shkencor është i organizuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/15 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Albanian University ka një organizim strukturor të kërkimit shkencor duke filluar nga aktivitetet kërkimore-shkencore në nivel të njëjesisë bazë, në aktivitete në nivel fakultetesh, në aktivitete në nivel Universiteti si dhe</p>	

aktivitete në bashkëpunim me universitetet apo institucione të tjera kërkimore-shkencore si brenda edhe jashtë vendit. Personeli akademik publikon rregullisht artikuj dhe material shkencore si në përmbushje të detyrimeve për marrjen dhe avancimin në gradat shkencore ashtu edhe në drejtim të punës shkencore për rritje profesionale. Institucioni i ofron personelit akademik pjesëmarrjen në konferencat që organizon vetë AU si dhe botimin në revistën shkencore periodike "Optime". Vetë RVB thekson se AU duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme disponon një bazë të plotë të dhënash lidhur me projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës

Albanian University ka një bashkëpunim të gjerë me shumë institucione të tjera akademike dhe joakademike si brenda edhe jashtë vendit. Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione që përfshijnë aktivitete të cilat synojnë: a) bashkëpunime me natyrë përfitimi dypalësh; b) mbështetje të ndërsjellë të stafeve dhe vetë proceseve të punës së dy institucioneve; c) mbështetje të stafeve për rritje profesionale, etj.

Albanian University ka patur një vëmendje të ngritur ndaj bashkëpunimeve me institucione ndërkombëtare të tilla si: Universiteti Sigmund Frojd të Vjenës; Universitetin e Aquila-s dhe Universitetin e Padova-s në Itali; Istanbul Ayyansaray University; ISPE Kolegj Prishtinë, etj.

Vetë Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në Albanian University, për këtë vit akademik ka 11 marrëveshje aktive bashkëpunimi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar janë paraqitur në Aneksë, Tabela 18

Ashtu sic edhe na u komunikua edhe gjatë vizitës në AU, numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit ka qënë 20. Po 20 personel kanë marrë pjesë edhe në aktivitete shkencore jashtë ambjenteve të IAL apo edhe jashtë vendit duke paraqitur edhe prezantimet e tyre.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Shiko Aneksë, Tabela 19)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	

<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Numri i institucioneve me të cilat janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit për këtë program studimi (i referohemi atyre institucioneve që mund të mbulojnë fushën klinike) është shumë i vogël (vetëm 3), njëri prej të cilëve është Spitali Rajonal i Beratit. Për vetë rëndësinë që ka ‘Praktika Profesionale’ për formimin e studentit në këtë program ky mbulim është i pamjaftueshëm. Vetë studentët raportuan se praktikat zhvilloheshin, kryesisht, në institucione që siguroheshin prej vetë studentëve ose në vendin e tyre të punës.</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme tregon një vëmendje të ngritur ndaj nevojës për bashkëpunimin e stafit akademik në procese të tilla si: rishikimi i sulabuseve, organizmi i aktiviteteve kërkimore-shkencore me pjesëmarrjen e studentëve, etj.</p> <p>Personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë i njohin të drejtat dhe përgjegjësitë dhe, të koordinuar nga drejtuesja e Departamentit arrijnë të realizojnë një klimë të frytshme bashkëpunimi.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Albanian University ka mundësuar realizimin e një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione akademike dhe në fushën e shërbimeve, si brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Një pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit janë të lidhura me institucione të cilat ofrojnë shërbime, një profil i përshtatshëm për studentët e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Megjithatë numri i këtyre marrëveshjeve është i pamjaftueshëm duke konsideruar rëndësinë dhe përparësinë e praktikës profesionale për formimin e studentit në këtë program.</p> <p>Institucioni ofron trajnime të përvitshme për stafin akademik, kryesisht në fushën e mësimdhënies.</p> <p>Nuk ka të dhëna që Albanian University apo vetë Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme të bëjë një analizë të përfitimeve të ndërsjellta që burojnë nga realizimi i frytshëm i marrëveshjeve të bashkëpunimit, si për stafet akademike ashtu edhe për vetë studentët që ndjekin studimet në këtë program.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme disponon një bazë të plotë të dhënash lidhur me projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. Personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë i njohin të drejtat dhe përgjegjësitë dhe, të koordinuar nga drejtuesja e Departamentit arrijnë të realizojnë një klimë të frytshme bashkëpunimi. Institucioni ofron trajnime të përvitshme për stafin akademik, kryesisht në fushën e mësimdhënies.</p> <p>Nuk ka të dhëna që Albanian University apo vetë Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme të bëjë një analizë të përfitimeve të ndërsjellta që burojnë nga realizimi i frytshëm i marrëveshjeve të bashkëpunimit, si për stafet akademike ashtu edhe për vetë studentët që ndjekin studimet në këtë program.</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Në përfundim të procesit të parë të Akreditimit, në vendimin Nr. 355, datë 13.07.2012, Këshilli i Akreditimit ka dhënë rekomandimet e mëposhtme, për të cilat GVJ bën konstatimet e mëposhtme:

- a) Të përmirësohet ambienti i bibliotekës - Ky rekomandim është plotësuar pjesërisht nga institucioni.
- b) Praktika mësimore për programin e studimit Master Profesional të jetë më e prekshme në terren - Ky rekomandim vazhdon të mbetet i paplotësuar me gjithë përpjekjet e institucionit për mbarëvajtjen e praktikës profesionale në këtë program studimi.
- c) Të sigurohet që studentët e këtij program studimi dyhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare - studentët e ciklit të dytë "Master Profesional" përjashtohen nga ky detyrim.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Institucioni ka ambiente të mjaftueshme për të zhvilluar këtë program studimi.
- 2) Institucioni vë në dispozicion të studentëve aksesueshmërinë e bibliotekës on-line, për përmbushjen e njohurive të plota nëpërmjet literaturës së huaj
- 3) Plan programet janë të hartuara sipas modelit Europian të kurrikulave dhe të bazuara në kompetencat që u ofrohen studentëve nëpërmjet zhvillimit të ë lëndëve.

b. Pika të dobëta:

- 1) Departamenti i Psikologjisë në këtë program studimi ka hasur vështirësi në rekrutimin e stafit të brendshëm, gjë e cila është e pasqyruar dhe në raportin e vlerësimit të brendshëm.
- 2) Mungesa e bashkëpunimit për praktikën e studentëve me institucionet përkatëse të cilat aplikojnë dijet e marra në këtë program studimi.
- 3) Nevojitet anagazhim më i lartë i studentëve të këtij programi në aktivitetet ekstrakurrikulare
- 4) Mungesa e projekteve konkrete të cilat do të gjenerojnë të ardhura shtesë në këtë program studimi.

c. Mundësitë:

- 1) Ngritja e "Urdhrit të Psikologut" si një lehtësi për të rritur punësimin në fushën e Psikologjisë Klinike, tashmë si një profesion i rregulluar.
- 2) Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikën e studentëve me institucionet përkatëse në vend, në të cilat punojnë vetë anëtarët e stafit akademik, si efektiv ashtu edhe me kontratë. Në këtë mënyrë mund të rritet edhe efikasiteti i praktikës profesionale.
- 3) Përfshirja e studentëve të programit të studimit në aktivitete ku të prezantohen teknikat terapeutike në trajtim e çrregullimeve të ndryshme psikologjike të organizuara nga pedagogë të ftuar jashtë institucionit përmes shfrytëzimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me qendra dhe institucione të licensuara në fushën e Psikologjisë Klinike dhe fusha të tjera të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me të.
- 4) Zotërimi i një shtypshkronje e cila mund të rriste titujt e librave që të mund të shërbenin si literaturë për këtë program.
- 5) Rrjeti i "Albanian College" si dhe aktivitetet e tjera mbështetëse të AU, mund të shërbejnë si një terren i përshtatshëm praktikë profesionale dhe punësimi të ardhshëm për studentët e diplomuar në këtë program.

d. Pengesat:

- 1) Vështirësia për rekrutimin e stafit akademik me tituj e grada në këtë program studimi.
- 2) Moskonsolidimi aktual i tregut të punës rrezikon mundësitë për punësim të diplomuarve në këtë program studimi.
- 3) Mungesa e një kuadri të rregulluar ligjor dhe etik sa i takon mbështetjes së praktikave profesionale frenon shumë institucione për t'u angazhuar si pritëse të studentëve.

**SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF PROFESSIONAL MASTER IN CLINICAL
PSYCHOLOGY**

I. SUMMARY ANALYSIS ABOUT COMPLETING THE RECOMMENDATIONS GIVEN IN THE PREVIOUS ACCREDITATION

As stated in the end of the first Accreditation process, given in the Order no 355, date 13.07.2012, the Accreditation Council gave the below listed recommendations, based on which the External Evaluation Group reached the following conclusions:

- a) Improvement of the library facilities - This recommendation is partly met.
- b) The professional practice for the Professional Master Program should be more field-oriented. Regardless of the efforts of the institution for the enhancement of the professional practice, this recommendation is still not met.
- c) The institution should make sure that by the end of the studies, all the students should have given the English language exam, through internationally recognized exams – students of Professional Master Programmes are excluded by this obligation.

II. SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION GROUP ACCORDING TO SWAT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

a. Strengths:

- 1) The institution utilizes considerable facilities for this program.
- 2) All the students are given access to an online library to fulfill their knowledge through foreign literature.
- 3) All syllabuses are designed according to European Curriculum Framework, making them skills-grounded.

b. Weaknesses:

- 1) The Department of General Psychology has countered different difficulties in the process of recruitment of full-time staff members, as reflected in the Internal Evaluation Report.
- 2) Lack of collaboration with relevant institutions for supporting professional practices that would help students to apply their knowledge.
- 3) Higher engagement of students in extracurricular activities for the specific programme is needed.
- 4) Lack of concrete projects aiming to generate incomes for other relevant activities for the programme.

c. Opportunities:

- 1) Considering the set up the “Order of Psychologists” as a good opportunity for enhancing future employment of Clinical Psychologists.
- 2) Possibility of signing ‘Memorandum of Understanding’ with institutions that staff members are themselves involved in their clinical practice. This can lead to a better efficiency of the professional practice as well.
- 3) Engagement of students of this program in specific activities where they can monitor therapeutic techniques in psychological treatments of different disorders, given by guest psychologists. This can be achieved through “Memorandums of Understanding” with specific institutions working in this particular area.



- 4) Possession of a printery that can be utilized to increase the literature for this programme.
- 5) The “Albanian College” network as well as other supporting activities of Albanian University, can serve as a suitable setting for professional practices and future employment of students graduated in this programme.


d. Threats:

- 1) Difficulties for recruitment of academic staff with relevant academic credentials.
- 2) Lack of labour market consolidation is a threat to further employment of students graduated in this programme.
- 3) Lack of a legal and ethical framework in relation to supporting professional practices withholds the engagement of many institutions to serve as hosting placements for students.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

External Evaluation Group

1. Prof Asoc. Dr. Arjana Mucaj
2. Dr. Silvana Loka



Përgjigje nga Grupi I Vlerësimit të Jashtëm në lidhje me komentet e bëra nga AU për Draft RVJ në programin Mp në “Psikologji klinike”

Grupi i vlerësimit të jashtëm pasi lexoi me kujdes përgjigjen e Universitetit Privat “Albanian University” në lidhje me Draft RVJ për programin në proces të riakreditimit, merr në konsideratë disa prej këtyre komenteve duke bërë ndryshimet përkatëse në raportin përfundimtar. Komentet e tjera nuk ndryshojnë dhe ashtu ngelen edhe në Raportin përfundimtar, duke dhënë edhe përgjigje pse nuk ndodh ky ndryshim. Më specifikisht:

1. **GVJ në Draft RVJ:** Sa i takon specifikisht programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike, pas një vëzhgimi në mjediset e bibliotekës, biblioteka vazhdon të jetë e varfër, jo vetëm në tituj mbështetës për punë të avancuar të studentëve, por edhe në tituj të literaturës së detyrueshme apo të rekomanduar për lëndët e vetë programit.
 - **Përgjigje nga AU:** Për këtë rekomandim Institucioni ka bërë përpjekje për të përmirësuar bibliotekën dhe për të shtuar sasinë e librave në ndihmë të programit të studimit. Në bibliotekë gjenden disa tituj librash që përdoren në ndihmë të studentëve. Disa nga pedagogët punojnë me cikle leksionesh të cilat i vënë në dispozicion të studentëve dhe depozitohen çdo vit në Njësinë bazë. Por duke ju referuar sugjerimit tuaj për semestrin e dytë do të shikohet mundësia për ofrimin e të gjitha teksteve në ndihmë të programit. Pjesë e bibliotekës janë dhe libraritë online si Questia.
 - **Përgjigja nga GVJ për mos ndryshim të Raportit:** Duke marrë në konsideratë faktin se ky rekomandim është dhënë në vitin 2012, vlerësojmë se numri i vogël i titujve për këtë program reflekton nivel të ulët përparësie në këtë drejtim. Libraria online Questia.com vlerësohet si një kontribut i rëndësishëm, por duke marrë në konsideratë se literatura e gjendur aty është në gjuhën angleze, kjo nuk e lehtëson punën e një studenti të programit të studimit “Master Profesional në Psikologjinë Klinike”, për aq kohë sa njohja e gjuhës së huaj nuk është kriter i përzgjedhjes për këtë programet e studimit Master Profesional. Për këtë nuk ndryshon asgjë në Raport.

2. **GVJ në Draft RVJ:** Institucioni nuk zotëron dokumentacion zyrtar, i cili të dëshmojë plotësimin e këtyre kritereve sipas detyrave të ngarkuara nga Urdhri i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 327, datë 07.08.2012, në pikën 3, e cila përcakton që Albanian University do të duhet t’i plotësojë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Akreditimit, në vendimin Nr. 355, datë 13.07.2012, përpara fillimit të vitit akademik 2012-2013.
 - **Përgjigje nga AU:** Në Urdhrin e Akreditimit nr.327, dt.07.08.2012, dhe Vendimin e KA nr. 355, dt.13.07.2012 nuk citohet në asnjë vend (ndryshe nga disa raste të tjera) që Institucioni duhet të raportojë në Ministri të Arsimit apo në APAAL mbi plotësimin e këtyre rekomandimeve. Pavarësisht, përpjekjet nga Institucioni për plotësimin e këtyre rekomandimeve kanë nisur në vitin akademik 2012-2013 dhe vazhdojnë të jenë në vëmendje të njësisë në vijimësi. Pasurimi i bibliotekës dhe shtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit janë rezultat i një pune të vazhdueshme dhe po ashtu janë pjesë e objektivave të këtij programi studimi.
 - **Përgjigja nga GVJ për mos ndryshim të Raportit:** Mungesa e një dokumenti zyrtar për plotësimin e këtyre kushteve dhe deklarimi se këto kushte po vazhdojnë të plotësohen, reflekton statusin e paqartë të plotësimit të këtyre kushteve për vitin akademik 2012-2013 dhe në vijim.

3. **GVJ në Draft RVJ, fq 5:** Ky program nuk është paraprirë dhe as është shoqëruar me një studim tregu, i cili do të mundësonte vlerësimin objektiv të nevojave të tregut të punës për psikologë klinikë.
 - **Përgjigje nga AU:** Për këtë program studimi, departamenti ka realizuar një studim tregu, i cili është vënë në dispozicion të GVJ si evidencë nr 7.2. Departamenti dhe Institucioni janë të vetëdijshëm për vështirësinë e realizimit të një studimi të mirëfilltë për të vlerësuar nevojat e tregut shqiptarë të punës për profesionin e psikologut klinik. Institucioni konsideron në të ardhmen ndërmarrjen e një iniciative të tillë, duke angazhuar staf të dedikuar për këtë çështje me shumë rëndësi, në projektimin e këtij programi në të ardhmen.
 - **Përgjigja nga GVJ për mos ndryshim të Raportit:** RVJ është hartuar bazuar mbi cfarë është gjetur në institucion në periudhën e vlerësimit. Dokumenti të cilit i referoheni (evidence 7.2) përmban vlerësimet e institucionit për nevojën dhe ecurinë e këtij programi studimi, por nuk mund të cilësohet një Studim Tregu, ashtu sikurse edhe deklarohet edhe në vetë përgjigjen e mësipërme të Institucionit.

4. GVJ në Draft RVJ, Fq.8: Për titujt dhe gradat e personelit akademik të Departamentit përgjegjës të programit të studimit ndër vite, në dokumentacionin e ngarkuar në sistem nga AU nuk jepen të dhëna.
- Përgjigje nga AU: *Bashkëngjitur gjeni listën e stafit akademik në nivel departamenti ndër vite, me titujt dhe gradat përkatëse. (Evidencë nr.1)*
 - Përgjigja nga GVJ: Evidenca ka ardhur së bashku me përgjigjen nga AU. GVJ e merr në konsideratë dhe reflekton në Raportin përfundimtar.
5. GVJ në Draft RVJ, fq.11: Vihet re një mospërputhje sa i takon personelit akademik të deklaruar si i angazhuar në programin e studimit Master profesional në Psikologji Klinike, për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019. Në RVB, PAE/PAK janë pasqyruar në tabelën 4 në Aneks: Ndërkohë që, në tabelat e kërkuara nga GVJ gjatë vizitave në institucion nuk është përmendur Dr. L. N.
- Përgjigje nga AU: *Sqarojmë se kjo mospërputhje ka ndodhur për arsye se lënda "Psikologji Pozitive" që zhvillohet nga pedagogje Dr.S.D. është një lëndë që zhvillohet me zgjedhje. Për këtë arsye në raport është vendosur edhe emri i pedagoges Dr.L.N, pasi në kohën e hartimit të RVB, nuk ishte bërë akoma zgjedhja nga studentët.*
 - Përgjigja nga GVJ: Merret në konsideratë dhe reflektohet në Raportin përfundimtar.
6. GVJ në Draft RVJ, fq.11: Ashtu sikurse u paraqit edhe më sipër, raporti i PAE/PAK të angazhuar në vitin akademik 2018-2019 (Shiko Aneks Tabela 6) në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Klinike është 1/3. Përpos mospërputhjes së këtij raporti të deklaruar nga burime të ndryshme (RVB, drejtuese e departamentit, takim me GVB, takim me stafin akademik, takim me Zyrën e Burimeve Njerëzore si dhe takim me studentët), drejtuesja e departamentit deklaroi se ky raport është rregulluar duke e rritur ngarkesën e mbuluar nga PAE gjatë semestrit të dytë, por kjo ngarkesë nuk është pjesë e këtij vlerësimi.
- Përgjigje nga AU: *Njësia bazë është përpjekur që lëndët të zhvillohen nga ekspert të fushave përkatëse, dhe kjo është arsyeja që pjesa më e madhe e lëndëve në semestrin e parë mbulohen nga PAK, duke bërë të mundur balancimin e mbulimit të ngarkesës me staf efektiv në semestrin e dytë. Përlllogaritja e ngarkesës mësimore dhe mbulimi me pedagogë efektiv ose me kontratë bëhet në baze viti, dhe jo semestri.*
 - Përgjigja nga GVJ për mos ndryshim të Raportit: Aneks kontratat e analizuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore ishin semestrale. Për këtë arsye ky GVJ nuk mund të konsiderojë asnjë deklaratë të pambështetur në dokumentacion zyrtar të vetë institucionit.
7. GVJ në Draft RVJ, fq.13: Sa i takon realizimit të ngarkesës në masën 70% nga PAE, sipas përcaktimeve ligjore, kjo nuk është realizuar për këtë periudhë të vitit akademik 2018-2019, në të cilën është ky mbulim është në masën 10%.
- Përgjigje nga AU: *Për sa i përket realizimit të ngarkesës në masën 70 % nga PAE, sipas përcaktimeve ligjore, kjo nuk është realizuar vetëm për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019. Saktësim ngarkesa e mbuluar nga staf efektiv, për semestrin e parë ka qenë 20%, siç është paraqitur në evidencën e dorëzuar gjatë vizitës në Institucion. (Për sem.I, 61 nga 297 orë mësimore në total, janë mbuluar nga PAE Dr.E.I, pra 20%) Dhe ashtu sikurse i është komunikuar edhe vlerësuesve gjatë vizitës në institucion në semestrin e dytë e gjithë ngarkesa është planifikuar të mbulohet nga PAE, duke ndikuar kështu në mbulimin e ngarkesës (vjetore) nga staf efektiv në masën 60%, për vitin akademik 2018-2019. (Bashkëngjitur evidencë nr. 2 - ngarkesa mësimore vjetore) Mbulimi i ngarkesës për çdo program studimi llogaritet në bazë vitit akademik dhe jo semestri. Megjithatë njësia bazë në vitet e ardhshme do bëjë përpjekje të mbulojë ngarkesën mësimore me staf efektiv gjatë gjithë vitit.*
 - Përgjigja nga GVJ: GVJ merr në konsideratë ndryshimin e masës së mbulimit të ngarkesës nga 10% në 20%, duke bërë edhe ndryshimin përkatës në Raport (bazuar në Evidencën Nr 1 të sjellë nga AU së bashku me Komentet për Draft RVJ). Sa i takon përmbushjes së detyrimit ligjor për të mbuluar ngarkesën në masën 70% me PAE, ritheksojmë se aneks kontratat e analizuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore ishin semestrale. Për këtë arsye ky GVJ nuk mund të konsiderojë asnjë deklaratë të pambështetur në dokumentacion zyrtar të vetë institucionit.
8. GVJ në Draft RVJ, fq.12: Në RVB mungojnë të dhëna lidhur me cilësitë dhe kualifikimet e stafit ndihmës/administrativ, me përjashtim të të dhënave lidhur me moshën e tij (25-30 vjeç).
- Përgjigje nga AU: *Në Tabelën 1 fq. 9 , është e shprehur në RVB që personeli administrativ mbulohet nga personel me gradën MSC*
 - Përgjigja nga GVJ: Merret në konsideratë dhe reflektohet në Raportin përfundimtar.

9. GVJ në Draft RVJ, fq.12 & Konkluzionet e Vlerësimit fq.14: Gjatë takimit me Drejtuesen e departamentit dhe GVB u deklarua se në fillim të çdo viti akademik Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen rishikimin e syllabuseve, me qëllim përmirësimin e tyre dhe ia përcjell departamentit.
- Përgjigje nga AU: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk bën rishikimin e syllabuseve, por janë grupet e Sigurimit të Cilësisë të ngritur në nivel departamenti të cilët në bashkëpunim me pedagogët përkatës bëjnë rishikimin e syllabuseve. Ky proces monitorohet nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave.
 - **Përgjigja nga GVJ**: Merret në konsideratë dhe reflektohet në Raportin përfundimtar.
10. GVJ në Draft RVJ, fq.19: Risia e këtij viti akademik ishte realizimi i fokus-grupeve....
- Përgjigje nga AU: NjSBC realizon fokus-grupe që prej vitit akademik 2016-2017. (Evidencë nr.3.1, 3.2, 3.3)
 - **Përgjigja nga GVJ**: Merret në konsideratë dhe reflektohet në Raportin përfundimtar.
11. GVJ në Draft RVJ, fq.21: Raporti vjetor i NjSBC, pasi miratohet në Senatin Akademik publikohet në faqen zyrtare të AU. Nuk kemi të dhëna që të dëshmojnë këtë aktivitet të NjSBC në Albanian University.
- Përgjigje nga AU: Raportet vjetore të NjSBC për 3 vitet e fundit gjenden në linkun: <https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/>
 - **Përgjigja nga GVJ**: Merret në konsideratë dhe reflektohet në Raportin përfundimtar.
12. GVJ në Draft RVJ: Konkluzionet e vlerësimit, fq.22: Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave mësimore, por vetëm në Tiranë pasi studentët nga rrethet e kryejnë praktikën në mjedisin e tyre të punës dhe nuk mbikqyren nga staf akademik.
- Përgjigje nga AU: AU i kushton një vëmendje të veçantë zgjerimit të rrjeteve të bashkëpunimit me Institucione të ndryshme që ofrojnë mundësi për realizimin e praktikave profesionale. Në mënyrë të vazhdueshme rinovohen marrëveshjet që janë parë efektive dhe ndërpriten marrëveshjet bashkëpunuese në rastet kur nuk ka më përfitime prej tyre. Praktikant profesional në programet e tjera por edhe në programin aktual zhvillohen mbi plane të përcaktuara dhe monitorohen nga stafi akademik përgjegjës vetëm për rrethin e Tiranës. Njësia bazë e mirëpret këtë sugjerim dhe në të ardhmen do të shikojmë mundësinë për të pasur dhe një mbikëqyrës për praktikantet e rretheve, duke garantuar që ato të finalizohen me sukses.
 - **Përgjigja nga GVJ për mos ndryshim të Raportit**: Çmohet fakti që ky sugjerim do të merret në konsideratë nga institucioni, por në kuadër të RVJ ky konstatim mbetet.
13. GVJ në Draft RVJ, fq.25: Gjatë vizitës u konstatua se kishte dhe 2 studentë të cilat vinin nga një fushë tjetër studimi, gjë që e bënte më të vështirë plotësimin e njohurive të marra në nivelin Bachelor.
- Përgjigje nga AU: Theksojmë që nuk është kusht pranimit për këtë program studimi, që studentët detyrimisht të zotërojnë diplomë Bachelor në "Psikologji". Studentët janë të informuar në lidhje me kriteret për t'u licencuar në ushtrimin e profesionit të psikologut. Ky informim bëhet si nga departamenti, por edhe nga stafi akademik i angazhuar në këtë program.
 - **Përgjigja nga GVJ për mos ndryshim të Raportit**: Studentët e cituar në RVJ nuk ishin të informuar për faktin se mungesa e një diplome Bachelor në Psikologji, pavarësisht diplomimit në Master Profesional në Psikologjinë Klinike do t'i pengonte për licensimin si Psikolog. Kjo pikë e RVJ nuk analizon kriteret e pranimit të studentëve, por vlerëson shkallën në të cilën ky program zgjeron njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve, i cili nuk është në Psikologji.
14. GVJ në Draft RVJ, fq.30: Në RVB si dhe përgjatë gjithë vizitës së GVJ në Albanian University nuk pati asnjë referencë (të dhëna zyrtare) lidhur me mobilitetin e mundshëm të studentëve të programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike. Në takimin me Sekretarinë Mësimore si dhe në të dhënat e RVB ka referenca sipas të cilave: në vitin akademik 2016-2017 ka patur 1 student të regjistruar në vit të parë si program i dytë studimi dhe në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 19 studentë në vitin e dytë të programit të studimit Master Profesional në Psikologji Klinike me transferim në vitin e dytë.
- Përgjigje nga AU: Duhet të theksojmë se këto 19 studentë janë studentë të transferuar dhe nuk konsiderohet mobilitet (kjo nisur edhe nga konsulenca me ekspertët e ASCAL).
 - **Përgjigja nga GVJ për mos ndryshim të Raportit**: Pikërisht këtë deklaron edhe ky paragraf në draft RVJ. Ka të dhëna zyrtare për student të transferuar, por nuk ka student që kanë përdorur mobilitetin e studentëve brenda sistemit të arimit të lartë në vend.
15. GVJ në Draft RVJ: Konkluzionet e vlerësimit fq.33: Edhe studentët, ashtu sikurse shkruhej në RVB dhe sikurse u konfirmua nga një anëtar i GVB, deklaruan se programi Master Profesional në Psikologji Klinike ofrohej me 90 ECTS.

- Përgjigje nga AU: Programi Master profesional në “Psikologji Klinike”, që prej akreditimit në vitin 2012 është ofruar me 70 ECTS. Duke nisur nga viti akademik 2018-2019, në zbatim të VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe udhëzimit të MASR nr.31, datë 29.12.2017, programi ofrohet me 60 ECTS. Siç kemi informuar edhe gjatë vizitës, në RVB ka qenë një lapsus përse i përket numrit 90 ECTS, e cila është përmendur vetëm 2 herë.
- **Përgjigja nga GVJ për mos ndryshim të Raportit:** Kjo fjali citon deklaratat e studentëve dhe anëtarit të GVB dhe nuk është përfundim i ardhur nga dokumenta të institucionit. Si i tillë qëndron sikurse është paraqitur në RVJ.

16. GVJ në Draft RVJ, fq. 34: Ndërkohë që mungojnë saktësime lidhur me natyrën e projekteve apo të fushës së çmimeve kombëtare (të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme), nëse ndonjëra prej tyre është e lidhur me shkencën e Psikologjisë apo jo. Mungojnë gjithashtu të dhëna lidhur me numrin e studentëve të programeve të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme të cilët kanë marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në aktivitetet e listuara në tabelën përmbledhëse.

- Përgjigje nga AU: Tabela Nr. 19 siç është e shënuar në RVB i referohen të dhënave në nivel Institucional për 5 vitet e fundit, ndërsa të dhënat në rang program studimi citohen në Tabelën 20. Ndërkohë, për sa i përket aktiviteteve dhe numrit të pjesëmarrjes së studentëve të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, Ju lutem referojuni evidencës nr.4.
- **Përgjigja nga GVJ:** Merret në konsideratë dhe reflektohet në Raportin përfundimtar.

17. GVJ në Draft RVJ, fq. 37: Nuk ka asnjë të dhënë që Albanian University të organizojë trajnime profesionale për mbështetjen e personelit akademik.

- Përgjigje nga AU: Institucioni ofron trajnime të përvitshme për stafin akademik kryesisht në fushën e mësimdhënies. (Evidenca nr.5)
- **Përgjigja nga GVJ:** Merret në konsideratë dhe reflektohet në Raportin përfundimtar.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof Asoc. Dr. Arjana Mucaj
2. Dr. Silvana Loka